

Çitaku: Qeveri pa adresë,
pa guvernator,
pa kryeprokuror dhe pa
rritje të pagave | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



FLET IDEATORI I PLATFORMËS "LIRIA KA EMËR", ISMAIL TASHOLLI | FAQE 4-5

'MARSHI PËR DREJTËSI' PO MERR MBËSHTETJE MAKSIMALE, UÇK-ja I PËRKET SECILIT QYTETAR



Ideatori i platformës "Liria ka emër", Ismail Tasholli, ka bërë me dije se "Marshi për drejtësi", që është në mbështetje të luftës së drejtë të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi

dhe bashkëluftëtarëve të tyre, po merr mbështetje maksimale. Ai ka thënë se më 2 prill ky marsh do të përçojë dy mesazhe: njëri mesazh do të jetë thirrje për drejtësi, tjetri për shprehje të mirënjohjes. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se UÇK-ja i përket secilit qytetar të këtij vendi, duke theksuar se ish-krerët e UÇK-së dhe bashkëluftëtarët e tyre nuk janë emra të përveçëm, por janë disa nga emrat e lirisë

AKTUALE



PJETËR SHALA KËRKON
QË DËSHMITARËT TË DËGJOHEN
NË SEANCA PUBLIKE | F.7

OSMANI: KOSOVA KA BËRË
PËRPARIM NË AVANCIMIN E
DEMOKRACISË DHE FORCIMIN E
SUNDIMIT TË LIGJIT | F.5

POLICIA NË SHQIPËRI
SEKUESTRON 8 000 FIDANË
KANABIS NË MALËSI TË MADHE | F.6

EKONOMI



GASTRONOMIA DHE HOTELERIA
PAGUAJNË 117.08 PËR QIND MË
SHUMË TATIM | F.8

PROJEKTILIGJI I RI PËR MBROJTJEN
E KONSUMATORIT SYNON
T'I MBROJË TË DREJTAT E TYRE | F.8

SPORT



MINISTRIA E SPORTIT, MINISTRIA
E MBROJTJES DHE FEDERATA
E XHUDOS NËNSHKRUAJNË
MEMORANDUM BASHKËPUNIMI | F.6

KONJUFCA
VAZHDON VIZITËN
NË UASHINGTON:
KOSOVA ËSHTË E
BEKUAR QË KA MIQ
SI SHBA-ja | FAQE 3



KOMUNAT
PO APLIKOJNË
KËRKESA
SHUMË TË LARTA
DISKRIMINUESE
NË DOSJE TË
TENDERËVE | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Grossi viziton centralin bërthamor të Ukrainës në Zaporizhja

KIEV, 29 MARS - Shefi i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore, Rafael Grossi, ka vizituar më 29 mars centralin bërthamor të Ukrainës në Zaporizhja - qytet në jug - i cili kontrollohet nga forcat ruse. Kështu njoftoi kompania shtetërore e energjisë bërthamore e Ukrainës, Enerhoatom, e cila tha se vizita e Grossit vjen si pjesë e përpjekjeve për të shmangur rrezikun e një aksidenti në centralin bërthamor. IAEA ka shprehur vazhdimisht shqetësime për sigurinë në Zaporizhja. Ky central bërthamor - më i madhi në Evropë dhe ndër dhjetë më të mëdhenjtë në

botë - ka qenë një nga shënjestrat e ushtrisë ruse prej nisjes së luftës në Ukrainë, në fund të muajit shkurt të vitit të kaluar. Moska dhe Kievi kanë fajësuar njëri-tjetrin për bombardimet rreth centralit, të cilat kanë rritur shqetësimet për katastrofë bërthamore. Të hënën, Grossi u takua në rajonin e Zaporizhjas me presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, i cili bëri një vizitë të papritur në pozicionet e vijës së parë të frontit në këtë rajon. Kjo është vizita e dytë e Grossit në këtë central që nga nisja e luftës në Ukrainë - mbi një vit më parë.



Zelensky: Ukraina duhet ta ruajë kontrollin e Bahmutit

KIEV, 29 MARS - Ushtria ukrainase ka thënë se forcat e saj kanë zbrapsur më shumë sulme ruse në Bahmut, teksa presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka thënë se Kievi nuk mund ta përballojë humbjen e betejës në këtë qytet në rajonin e Donjeckut. "Armiku vazhdon sulmet në qytetin e Bahmutit", ka thënë Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase në raportin ditor. "Megjithatë, mbrojtësit tanë janë duke e mbajtur me kurajë qytetin, duke zbrapsur një mori të sulmeve të armikut", ka thënë mes tjerash ushtria. Bahmuti, bashkë me qytetet tjera Avdivka, Marinka dhe Liman, janë shënjestrat kryesore të Rusisë, sipas ushtrisë ukrainase. Duke folur për rëndësinë e kontrollit të Bahmutit, Zelensky ka paralajmëruar se fitorja e Rusisë në atë qytet mund të përdoret nga presidenti rus, Vladimir Putin si kusht në ndonjë marrëveshje eventuale për paqe, çka nënkupton se Ukraina do të duhej të bënte kompromise të dhimbshme. Putin "do t'ia shiste këtë fitore Perëndimit, popullit të tij, Kinës, Iranit", ka thënë Zelensky në një intervistë për agjencinë e lajmeve,



Associated Press. Komandantët ushtarakë ukrainas kanë thënë se kundëroffensiva e tyre mund të ndodhë shpejt, mirëpo ndërkohë dëshirojnë që ta ruajnë edhe kontrollin në Bahmut. Më 28 mars, Zelensky ka thënë se bota duhet të reagojë me më shumë urgjencë për ta ndaluar agresionin rus. Ai ka thënë se beson se "agresioni rus mund të përfundojë shumë më shpejt" sesa që disa kanë menduar. Do të përfundojë më shpejt "nëse

bota vepron më shpejt, nëse bota është më e vendosur", ka deklaruar ai para popullit. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022. Presidenti rus, Putin, e quan luftën si "operacion special ushtarak" për të çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

BE-ja kërkon mundësi ligjore për ta ndaluar importin e gazit rus

BRUKSEL, 29 MARS - Vendet e Bashkimit Evropian ranë dakord të kërkojnë një opsion ligjor për t'ua ndaluar kompanive ruse që të dërgojnë gaz natyror të lëngshëm (LNG) në vendet e BE-së. Propozimi i vendeve është pjesë e pozicionit të tyre negociues mbi rregullat e reja të tregut të gazit të BE-së. I njëjti nuk është përfundimtar dhe do të duhet të negociohet me Parlamentin Evropian - një proces që mund të marrë muaj. BE-ja prej 27 vendesh është zotuar të heqë dorë nga gazi rus në përgjigje të pushtimit të Ukrainës nga Moska. Importet evropiane të gazit nga Rusia janë ulur që nga pushtimi, por importet e gazit të lëngshëm natyror janë rritur. Dërgesat e gazit natyror të lëngshëm rus në Evropë u rritën vitin e kaluar në 22 miliardë metra kub, nga rreth 16 miliardë metra kub në 2021, sipas një analize të BE-së, të cilën e ka parë "Reuters".



Shefi i Bankës Qendrore Evropiane pret "rënie të shpejtë" të inflacionit

FRANKFURT, 29 MARS - Banka Qendrore Evropiane pret rënie të shpejtë të inflacionit të lartë në Eurozonë, sipas shefit të këtij institucioni, Philip Lane. Inflacioni veçse ka rënë në muajt e fundit. Mirëpo në nivelin sa është tani, 8.5 për qind, është ende përtej synimit të Bankës Qendrore Evropiane prej 2 për

qind. Aktualisht, ne ndoshta jemi "në fazën më intensive të inflacionit", ka thënë Lane. "Çmimet e ushqimit janë ende shumë të larta dhe kjo është ajo me të cilën përballen njerëzit kur shkojnë në dyqan". Por, sipas tij, nëse analizohen çmimet paraprake për përbërësit ushqimorë,

"vërehet ndryshimi". "Ka përmirësim, që do të jetë gradual në pranverë dhe verë, por më i fuqishëm do të jetë në vjeshtë", ka thënë mes tjerash ai. Por, për të siguruar shkallë të inflacionit në 2 për qind, Lane ka thënë se do të duhet të ketë sërish rritje të normës së interesit për hua.



Konjufca vazhdon vizitën në Uashington: Kosova është e bekuar që ka miq si ShBA-ja

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

WASHINGTON, 29 MARS - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, në vazhden e vizitës së tij zyrtare në ShBA, është pritur në takim nga ish-kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan, Nancy Pelosi. Kryetari Konjufca dhe kongresistja Pelosi shkëmbyen pikëpamje për zhvillimet në rajon dhe arenën ndërkombëtare, forcimin e bashkëpunimit dypalësh, rëndësinë e avancimit në proceset euroatlantike dhe vazhdimin e mbështetjes së Republikës së Kosovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kreu i Kuvendit të Kosovës potencoi se Kosova dhe ShBA-ja

ndajnë të njëjtat vlera dhe parime të lirisë e demokracisë dhe se çdo ditë e më tepër po i zgjerojnë fushat e bashkëpunimit të ndërsjellë. "Kosova dhe populli ynë janë të bekuar që kanë miq kaq të mrekullueshëm dhe përkrahjen e pakursyer të Shteteve të Bashkuara", ka theksuar Konjufca. Në takim morën pjesë edhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Uashington DC, Ilir Dugolli dhe shefi i stafit, Ilir Kërçeli.

Konjufca falënderon kongresistin Torres për përkrahjen ndaj Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka vazhduar vizitën e tij zyrtare në Uashington,



me takime me anëtarë të Senatit dhe të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan. Në kuadër të këtyre takimeve, Konjufca është pritur nga kongresisti Ritchie Torres, me të cilin ka diskutuar për bashkëpunimin e ngushtë

Kosovë - ShBA, për zhvillimet politike në shtetin tonë dhe për mbështetjen amerikane e për proceset euroatlantike të Republikës së Kosovës.

Konjufca ka shprehur mirënjohjen për përkrahjen e

vazhdueshme të kongresistit Torres ndaj Republikës së Kosovës dhe përkushtimin e tij në forcimin e miqësisë dhe thellimin e marrëdhënieve dypalëshe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Kurti viziton shtëpinë-muze të familjes Qerkezi, pritët nga nënë Ferdonija

GJAKOVË, 27 MARS - Në përvjetorin e 24-t të rrëmbimit të 11 burrave dhe djemve të Gjakovës, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, sot ka vizituar shtëpinë-muze të familjes Qerkezi. Ai është pritët nga nënë Ferdonije Qerkezi.

Kryeministri Kurti e ka falënderuar nënën Ferdonije për qëndrueshmërinë dhe guximin që po i jep mbarë popullit shqiptar. Ai ka thënë se forcat serbe nuk i kanë marrë katër djemtë dhe bashkëshortin e saj sikurse dhe shumë e shumë të tjerë se kanë qenë të familjes Qerkezi, por sepse kanë qenë shqiptarë dhe e kanë dashur vendin e tyre. "E di që dhembja nuk zvogëlohet, por në të njëjtën kohë ajo të ka mbajtur ty gjatë të fuqishme dhe një komb të tërë e ka ngritur në solidaritet me familjen Qerkezi, me nënën Ferdonije", ka shprehur qëndrimin

Kurti.

Kryeministri ka veçuar rëndësinë e hapjes së arkivave nga Serbia pasi, sipas tij, vrasjet dhe zhdukjet gjatë luftës kanë qenë pjesë e projektit serbomadhi për shfarosjen e shqiptarëve. Ai ka thënë tha se Serbia duhet të jetë e hapur për sa më shumë hulumtim dhe hapje të varrezave masive. Por, ka theksuar se fakti që në varrezat masive të zbuluara në Serbi nuk ka të vendosur asnjë pllakë përkujtimore, është dëshmi që Serbia nuk do që të zbulohet e vërteta.

Nëna Ferdonije e ka falënderuar kryeministrin Kurti për vizitën në shtëpi. Më 27 mars 1999 janë rrëmbyer bashkëshorti i nënës Ferdonije, Halimi me katër djemtë, Artanin, Armendin, Ardianin dhe Edmondin, nipi i saj Vegim Qerkezi, miku i shtëpisë



Shpejtëm Ymeraga, si dhe fqinjët Skender Dylhasi me djalin Myrteza dhe dy djemtë e familjes Jetishi, Shpendi e Fatosi.

Bashkë me nënën Ferdonije ishte edhe nëna Dudije Dylhasi së cilës

forcat serbe ia kanë rrëmbyer djalin Myrteza dhe bashkëshortin Skënderin.

Gjatë vizitës së tij kryeministri ka shkruar në librin e kujtimeve: "Artani e Armendi, Ardiani e

Edmondi, janë djemtë që i mungojnë Nënës Ferdonije, sepse ishin shqiptarë si të gjithë NE, që e donin vendin e tyre. Tash jemi të gjithë djem të saj, e ajo është Nënë e gjithë popullit tonë, sepse çdonjëri e njeh dhe e do si nënë. 24 vjetët nga rrëmbimi i katër djemve dhe i bashkëshortit Halimit nuk ia kanë zvogëluar dhembjen, por ia kanë shtuar forcën që ajo e ka bartur te ne të gjithë. E duam si Nënë, e admirojmë si Heroinë, i falënderohemi për jetë, i kemi borxh secili".

Në këtë vizitë bashkë me kryeministrin Kurti ishin edhe Andin Hoti, kryesues i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, si dhe ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Abërie Nagavci dhe deputetja Mimoza Kusari.

Çitaku: Qeveri pa adresë, pa guvernator, pa kryeprokurotor dhe pa rritje të pagave

Prishtinë, 29 mars - Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka kritikuar qeverisjen e drejtuar nga Albin

Kurti. Ajo ka thënë se kjo qeveri është pa adresë. Ajo ka drejtuar kritika në adresë të qeverisë për mosemërimin e guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës,

për mosemërimin e kryeprokurorit të shtetit dhe për mungesën e bordit të Trustit. "Një qeveri pa adresë, pa ambicie, pa vizion. Një

qeveri pa guvernator, pa kryeprokurotor, pa bord të Trustit, pa rritje të pagave dhe pa, pa, pa", ka shkruar Çitaku në "Facebook".





FLET IDEATORI I PLATFORMËS “LIRIA KA EMËR”, ISMAIL TASHOLLI

‘Marshi për drejtësi’ po merr mbështetje maksimale, UÇK-ja i përket secilit qytetar

Ideatori i platformës “Liria ka emër”, Ismail Tasholli, ka bërë me dije se “Marshi për drejtësi”, që është në mbështetje të luftës së drejtë të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarëve të tyre, po merr mbështetje maksimale. Ai ka thënë se më 2 prill ky marsh do të përçojë dy mesazhe: njëri mesazh do të jetë thirrje për drejtësi, tjetri për shprehje të mirënjohjes. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re” ai ka thënë se UÇK-ja i përket secilit qytetar të këtij vendi, duke theksuar se ish-krerët e UÇK-së dhe bashkëluftëtarët e tyre nuk janë emra të përveçëm, por janë disa nga emrat e lirisë

periudhën më të ndritur të historisë së re të vendit tonë qoftë edhe nëpërmjet simbolikës së marshit”, ka thënë ai.

Tasholli në këtë intervistë ka thënë se UÇK-ja i përket secilit qytetar të këtij vendi, duke theksuar se ish-krerët e saj, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarët e tyre, nuk janë emra të përveçëm, por janë disa nga emrat e lirisë. “Duhet të jemi shumë të vëmendshëm në kompleksitetin e ngjarjeve që po rrjedhin atje, duke lënë anash hidhërimet politike tipike ballkanike dhe ta dëshmojmë maturinë si veprim të përbashkuar. Mos ta harrojmë, duke mbrojtur ata atje e mbrojmë vetveten, mbrojmë të ardhmen tonë”, ka deklaruar Tasholli.

“Epoka e re”: Platforma “Liria ka emër” më 2 prill do të mbajë marsh për drejtësi në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së. Po dihet qëllimi i këtij marshi, por më gjerësisht cili do

të jetë mesazhi që do të jepni këtë të diel?

Tasholli: E kemi përsëritur në vazhdimësi rëndësinë dhe nevojën e përbashkimit të shoqërisë tonë rreth disa temave që janë premisa mbi të cilat janë ndërtuar dinjiteti dhe krenaria jonë kombëtare. Shenja që e ka fuqinë e ruajtjes së kohezionit shoqëror, pa asnjë dyshim, është UÇK-ja. Këtë të diel e kemi mundësinë e përcimit të dy mesazheve. Njeri mesazh do të vijë në formën e thirrjes për drejtësi, tjetri mesazh do të jetë ai i mirënjohjes. Mirënjohjes së atyre që dikur marshuan për liri. Sepse fara më e keqe që mund të mbillet në një shoqëri është mosmirënjohja dhe nuk guxon të na ndodhë kjo.

“Epoka e re”: Keni pasur disa takime me parti politike, organizata dhe shoqata të ndryshme. Sa keni mundur të merrni përkrahje për këtë marsh dhe a prisni që më 2 prill përkrahja të jetë e madhe?

Tasholli: Në secilin takim që kemi

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 MARS - Këtë të diel platforma “Liria ka emër” organizon marsh qytetar dhe solidarizues në mbështetje të luftës së drejtë të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarëve të tyre. Marshi do të nisët nga sheshi “Zahir Pajaziti” dhe do të vazhdojë në drejtim të sheshit “Skënderbeu”.

Deri më tani ky marsh ka marrë mbështetje të madhe nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, disa parti politike, deputetë, shoqëria civile, artistë, shoqata dhe organizata të ndryshme dhe nga disa oda ekonomike.

Ideatori i platformës “Liria ka emër”, Ismail Tasholli, në një intervistë për gazetën “Epoka e re”, ka theksuar se ky marsh do të përçojë dy mesazhe: njëri mesazh do të jetë thirrje për drejtësi, tjetri për shprehje të mirënjohjes. Ai ka

thënë se është i nevojshëm përbashkimi i shoqërisë sonë rreth disa temave që janë premisa mbi të cilat janë ndërtuar dinjiteti dhe krenaria jonë kombëtare.

Tasholli ka theksuar se deri më tani në çdo takim që kanë pasur, “Marshi për drejtësi” ka marrë mbështetje maksimale. “Të gjithë janë të vetëdijshëm për peshën e situatës ku ndodhemi sot dhe e konsiderojnë përkrahjen të nevojshme. Tekefundit, secili e respekton veten kur respekton

Osmani: Kosova ka bërë përparim në avancimin e demokracisë dhe forcimin e sundimit të ligjit

PRISHTINË, 29 MARS - Presidentja Vjosa Osmani ka bërë një adresim në Samitin për Demokraci, ku ka theksuar se Kosova ka bërë përparim të jashtëzakonshëm në avancimin e demokracisë, forcimin e sundimit të ligjit dhe luftimin e korrupsionit. "Demokracia është më shumë se thjesht një sistem qeverisjeje. Për Republikën e Kosovës ishte dëshira jonë e fortë për demokraci që siguroi rrugën tonë drejt lirisë dhe pavarësisë. Duke e forcuar atë sot, demokracia do të na hapë rrugën drejt një të ardhmeje më të ndritshme brenda institucioneve euroatlantike. Në vetë thelbin e saj, demokracia ka të bëjë me të drejtën për ta zgjedhur drejtimin, të ardhmen dhe fatin tuaj. Populli i Kosovës ka zgjedhur rrugën e vet", ka thënë Osmani.

Ajo ka theksuar se gjatë vitit të kaluar Kosova ka bërë përparim të jashtëzakonshëm në avancimin e demokracisë, forcimin e sundimit të ligjit dhe luftimin e korrupsionit. "Jemi duke e zbatuar Strategjinë Kombëtare për Sundimin e Ligjit, krahas reformave të pakompromis dhe me ritme rekorde për ta garantuar një qeverisje llogaridhënëse, të



barabartë dhe efektive në të gjitha institucionet publike", është shprehur Osmani. Ajo ka shtuar se një demokraci e

fortë është një demokraci që vepron edhe për gratë. "Ne kemi bërë hapa të rëndësishëm, por përderisa gratë vazhdojnë të

përballen me mizogjininë në vendet e punës, dhunën në shtëpi, heshtjen me forcë në klasë ose keqtrajtim gjatë ecjes në rrugë

- kjo betejë është larg përfundimit", ka deklaruar Osmani.

Presidentja ka theksuar se gjatë këtij viti të veprimit Kosova ka udhëhequr diskutimet globale për avancimin e të drejtave të grave duke qenë nikoqire e Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë me mbi 500 pjesëmarrës me ndikim në këtë fushë nga 6 kontinente, dhe në tetor të këtij viti do të mirëprehen të gjithë në edicionin e dytë në Prishtinë. "Përkushtimi ynë për demokraci nuk është vetëm një zotim i Samitit. Është ekzistenca jonë e përditshme në vijën e parë të frontit përballë autokracive. Përkushtimi ynë ka qenë dhe do të jetë gjithmonë i pathyeshëm. Përkushtimi ynë për të punuar me partnerë në mbarë botën për ta mbrojtur dhe ushqyer atë është i pathyeshëm. Siç tha kohët e fundit presidenti Biden: 'Në momentet e trazirave të mëdha dhe pasigurisë, gjëja më e rëndësishme është të dish se çfarë përfaqëson. Dhe të dish se kush qëndron me ty, e bën gjithë dallimin'. Vetëm përmes bashkimit të forcave mund ta ndërtojmë një të ardhme", ka thënë Osmani.

Ulet numri i pacientëve që trajtohen jashtë institucioneve publike



PRISHTINË, 29 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i shoqëruar nga u.d drejtoresha e ShSKUK-së, dr. Narqize Arenliu-Hoxhaj, vizitoi të mërkurën Klinikën e Oftalmologjisë në QKUK. Ai u prit nga drejtori i kësaj klinike, dr. Ardian Shabani. Gjatë kësaj vizite ministri Vitia u njoftua se me shërbimin e kirurgjisë vitreoretinale (operacionet në segmentin e pasmë të syrit - Pars Plana Vitrectomi - PPV) është zvogëluar numri i pacientëve që trajtohen jashtë institucioneve shëndetësore publike, nga 500 raste të referuara në vit siç ka ndodhur në të kaluarën, në rreth 100 raste në vit. "Këto shërbime

të reja, të cilat tani ofrohen në Klinikën e Oftalmologjisë, kanë ndikuar që të kursehen rreth 2 milionë euro të buxhetit si dhe janë kursyer xhepat e pacientëve. Shpreh mirënjohjen time të thellë për punën e palodhshme të stafit shëndetësor në Klinikën e Oftalmologjisë", ka thënë ministri Vitia.

Vitia, po ashtu, tha se Ministria e Shëndetësisë do ta ofrojë mbështetjen e saj të plotë për t'i mbuluar nevojat në bazë të rritjes së vëllimit të punës dhe shërbimeve në sallat operative, ambulancat specialistike, si dhe për të ofruar kushte më të mira të punës për stafin shëndetësor.

pasur thirrja jonë për mbështetje ka gjetur mirëkuptimin maksimal. Të gjithë janë të vetëdijshëm për peshën e situatës ku ndodhemi sot dhe e konsiderojnë si të nevojshme përkrahjen. Tekefundit, secili e respekton veten kur respekton periudhën më të ndritur të historisë së re të vendit tonë qoftë edhe nëpërmjet simbolikës së marshit.

"Epoka e re": A është e mjaftueshme kjo përkrahje?

Tasholli: Shpresojmë që do të jetë mjaftueshëm e dinjitetshme edhe pse kurrë nuk është boll për ata që i dhanë të gjitha për këtë vend.

"Epoka e re": Ju si ideator i platformës "Liria ka emër" keni

theksuar më herët se ky proces nuk ka të bëjë me emra të përveçëm, por me UÇK-në, një epokë e cila ka sjellë lirinë e këtij populli.

Tasholli: E vërtetë. Ne si shoqëri duhet ta ushtrojmë dhe zhvillojmë sensin e dallueshmërisë së asaj çfarë quajmë politike ditore dhe vlera të përgjeshme universale. Ata atje nuk janë emra të përveçëm. Ata atje janë disa nga emrat e lirisë. UÇK-ja i përket secilit qytetar të këtij vendi dhe mbi këtë fakt duhet ta mendojmë reagimin kur historia rrezikohet nga riinterpretimet e saj. Ajo se çfarë do të vendoset në Hagë do të përcaktojë jo vetëm të sotmen tonë, por edhe të ardhmen e Kosovës. Duhet të jemi shumë të

vëmendshëm në kompleksitetin e ngjarjeve që po rrjedhin atje, duke lënë anash hidhërimet politike tipike ballkanike dhe ta dëshmojmë maturinë si veprim të përbashkuar. Mos ta harrojmë, duke mbrojtur ata atje e mbrojmë vetveten, mbrojmë të ardhmen tonë.

"Epoka e re": Kanë kaluar dy vjet që ish-krerët e UÇK-së po mbahen në paraburgim. Si e keni parë ju këtë proces gjyqësor të Dhomave të Specializuara?

Tasholli: Nuk dua të flas për procesin si të tillë, sepse do të më duhej edhe autoriteti juridik të ma legjitimoj diskursin. Ka shumë paradokse, dilema dhe apori etike.



Kryetari i Gjilanit pret në takim njoftues komandantin e KFOR-it turk për Kosovë

GJILAN, 29 MARS - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur në takim njoftues komandantin e KFOR-it turk për Kosovë, Recai Yilmaz. Në këtë takim temë diskutimi ka qenë

sigurimi i ofrimit të bashkëpunimit të KFOR-it turk për komunën e Gjilanit.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për projektet ku mund të ndërveprojnë të dyja

palët dhe, si rrjedhojë, u dakordua që bashkëpunimi të vazhdojë edhe më tutje. Përveç kësaj, kryetari Hyseni e ka njoftuar komandantin për çështjet lidhur me planet e tij për qeverisje.



Policia në Shqipëri sekuestron 8 mijë fidanë kanabis në Malësi të Madhe

TIRANË, 29 MARS - Policia e Shtetit në Shqipëri ka zbuluar 27 sera me 8 mijë fidanë kanabis, të mbjellë në kubikë.

Malësia e Madhe është pjesë e qarkut të Shkodrës.

Aksioni është zhvilluar në vendin e quajtur "Badra e Mehajve" në Malësi të Madhe, në një zonë që ka shërbyer për të nxjerrë materie inerte.

Gropën e krijuar nga marrja e materieve inerte, trafikantët e drogës e kanë shfrytëzuar për ndërtimin e serave dhe mbjelljen e fidanëve.

Inertet e grumbulluara anash saj besohet se kanë shërbyer për ta fshehur serën e ndërtuar.

Policia ka bërë me dije se sera është ndërtuar 20 metra në thellësi të këtij krateri, ndërsa fidanët kanë qenë gati për t'u kultivuar në tokë, pas procesit të rritjes së tyre në kubikë. "Është arrestuar shtetasi me inicialet N. D., 52 vjeç, i dyshuar si organizator i kësaj veprimtarie kriminale. Po hetohen në gjendje të lirë tre punonjës të Bashkisë së Malësisë së Madhe, konkretisht drejtori i Shërbimit Pyjor, një specialist i Ujësjellësit dhe një hidraulik", ka thënë policia.

Në banesën e organizatorit të kësaj veprimtarie të paligjshme policia ka sekuestruar tri armë gjahu, pesë



armë të ftohta (thika) si dhe një sasi fishekësh.

Policia e Shkodrës u ka bërë thirrje fermerëve dhe banorëve të zonave rurale të mos jenë pre e individëve apo grupeve kriminale që merren me kultivimin e lëndëve narkotike. Aksioni më i madh i Policisë së Shtetit kundër kultivimit të bimëve

narkotike në ambiente të hapura është zhvilluar në nëntor të vitit të kaluar.

Atëbotë janë zbuluar disa sera dhe janë sekuestruar 870 kilogramë kanabis.

Në këto sera kanë qenë të punësuar rreth 100 gra, të cilat, pasi janë marrë në pyetje, janë

liruar, derisa në pranga kanë përfunduar 11 persona.

Një tjetër fenomen i përhapur së fundmi në Shqipëri është kalimi i ushtrimit të kësaj veprimtarie kriminale nga parcelat dhe serat, në ato që njihen si "shtëpi bari", ambiente si banesa, magazina apo tunele që përdoren për kultivim

bimësh narkotike.

Një ditë më parë, më 28 mars, Policia e Shtetit ka zbuluar dhe sekuestruar dy "shtëpi bari" në qytetin e Krujës, ku janë gjetur 268 bimë kanabis, 51 llamba dhe pajisje të tjera elektrike, që kanë shërbyer për kultivim në ambiente të mbyllura.



UShAF-i riakreditohet edhe për pesë vjet

FERIZAJ, 29 MARS - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) ka fituar edhe për pesë vjet akreditimin institucional nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC). Me këtë vendim, UShAF bëhet një nga dy universitetet publike në vend, (krahas Universitetit të

Prishtinës), të cilët janë akredituar për pesë vjet.

UShAF është universiteti i fundit publik i themeluar.

Rektori i UShAF-it, prof. dr. Agron Bajraktari, vlerësoi vendimin të cilin KShC-ja e ka marrë për universitetin. Gjithashtu, ai i falënderoi të gjithë ata të cilët

kanë qenë pjesë e procesit të akreditimit dhe kanë kontribuar për një të arritur të tillë.

Po ashtu, rektori falënderoi stafin akademik, administrativ, studentët, studentët e diplomuar, bizneset dhe partnerët e tjerë për kontributin dhënë gjatë këtij procesi.

AAK-ja mbështet marshin e 2 prillit: Gjithmonë kemi besuar në pafajësinë e pjesëtarëve të UÇK-së

PRISHTINË, 29 MARS - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i ka dhënë publikisht mbështetje marshit për drejtësi që organizohet këtë të diel në Prishtinë.

Përmes një deklaratë publike nga AAK-ja kanë thënë se gjithmonë kanë besuar në

pafajësinë e pjesëtarëve të UÇK-së dhe në vlerat e lirisë. "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës mbështet marshin për drejtësi që organizohet këtë të diel. Ne gjithmonë kemi besuar në pafajësinë e pjesëtarëve të UÇK-së dhe në vlerat e lirisë dhe e kemi mbështetur

drejtësinë ndërkombëtare me qëllim të pastrimit të luftës së drejtë të popullit shqiptar për liri. Të marshosh për drejtësi është e drejtë dhe vlerë demokratike dhe ne gjithmonë do të jemi në shërbim të vlerave dhe të drejtësisë", është thënë në deklaratën e AAK-së.



Pjetër Shala kërkon që dëshmitarët të dëgjohen në seanca publike

PRISHTINË, 29 MARS - Avokati mbrojtës i Pjetër Shalës, Jean-Louis Gilissen, ka kërkuar që seancat në këtë proces gjyqësor të jenë sa më shumë publike. Sipas tij, një gjykim duhet të jetë publik për të qenë i drejtë, pa përjashtuar kujdesin e sigurisë për të dhënat identifikuese të dëshmitarëve.

Në fillim të seancës të mërkurën, Gilissen ka folur rreth vendimit të Shalës për të mos marrë pjesë fizikisht në gjykatore dhe, sipas tij, një gjë e tillë po ndodh për shkak se pjesa më e madhe e dëshmitarëve po mbyllet për publikun. Sipas tij, Pjetër Shala kishte kontaktuar të martën me disa të njohur në

Belgjikë e të cilët kishin thënë se nuk po kuptojnë asgjë nga ajo çfarë po ndodh në sallën e gjyqit për shkak se dëshmia po dëgjohet në seancë private. "E takova dje në mbrëmje në objektin e paraburgimit, ishte shumë e vështirë të flisje me të, dhe dje humbëm, Shala nuk e ndoqi seancën, mund të them që sistemi gjyqësor po ashtu e humbi z. Shala. Shala dëshiron të jetë i pranishëm gjatë seancave. Kur ai më shpjegoi, dhe unë jam shumë i ndjeshëm, sepse është shumë delikate, më tha arsyen pse, ai e vlerëson që jemi të gjithë profesionistë dhe duhet ta mendojmë nga një pikëpamje më e

gjërë, më tha se ajo që ndjeu ai, mbase, për mirë apo për keq, ishte shumë e dhimbshme për të që po dëgjonte shumë nga gjërat që nuk po thuheshin në publik", ka thënë avokati. Ai ka thënë se Shala është i vetëdijshëm për çështjen e sigurisë së dëshmitarëve por, sipas tij, publiku duhet të dijë se çfarë po ndodh në sallën e gjyqit.

Lidhur me këtë, nga Zyra e Prokurorit të Specializuar kanë thënë se janë përpjekur që dëshmitarët t'i marrin në pyetje sa më shumë në seanca publike por, sipas tyre, kjo nuk është e mundur gjatë gjithë kohës. Ndërsa mbrojtësi i viktimave, Simon Laws, ka thënë

se prioritet duhet të jetë siguria e dëshmitarëve. Por sipas avokatit të Shalës, një gjyq duhet të jetë publik për të qenë i drejtë. "Një gjyq, për të qenë i drejtë, duhet të jetë publik. Ju lutem, prioriteti është një proces publik, është një garanci, por sigurisht se duhet të jemi të kujdesshëm sa i takon aspektit të sigurisë, veçanërisht bazuar në informacionin lidhur me identifikimin, të dhënat identifikuese për dëshmitarët dhe për sigurinë e tyre. Përkundrazi, me gjithë respektin, parashtrij dhe e theksoj këtë, seancat publike janë një garanci për gjykimin dhe në kundërshtim me mbrojtësin e

viktimave mund të them që jo, kjo është një gjë shumë e rëndësishme, këtu duhet ta gjejmë ekuilibrin. E dimë që është delikate për ju të nderuar gjykatës, është e vështirë për palët, por nuk duhet t'i harrojmë parimet, dhe parimi është seanca publike", ka thënë ai. Ndërsa kryetarja e turpit gjyqësor, Mappie Veldt Foglia, ka thënë se nëse trupi gjyqësor e kupton që një pjesë e transkriptimit të seancave që është në privat mund të rikalsifikohet si publik, do ta bëjnë një gjë të tillë. Këtë seancë Pjetër Shala e ka ndjekur nga qendra e paraburgimit përmes videolidhjes. (Kp)



Lansohet projekti për "Përafrimin e ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit"

PRISHTINË, 29 MARS - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në lansimin e projektit të Këshillimit të Evropës për "Përafrimin e ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit", për të cilin tha se është një hap i madh drejt barazisë. Në këtë ngjarje e pranishme dhe pjesëmarrëse ishte dhe ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. "Ky projekt ka për qëllim përafrimin e mëtejshëm të ligjeve dhe të politikave tona, e kjo pikërisht me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, një institucion tek i cili aspirojmë që të anëtarësohemi, sepse besojmë dhe kultivojmë vlerat e demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit", tha kryeministri Kurti.

Ai tha se secila përpjekje për barazi hap shtigje për emancipim dhe solidaritet. Sipas Kurtit, një hap i madh drejt barazisë është edhe ky traktat që na ka mbledhur sot e që njihet ndryshe si Konventa e Stambollit. Ai ka

bërë me dije se qeveria ka marrë përsipër obligimet që parasheh kjo konventë. "Po angazhohemi maksimalisht që të zbatojmë në përpikëri hapat e masat që kërkohen nga ne dhe ky angazhim yni mbështetet në një synim të thjeshtë: që asnjë grua të mos jetojë me frikën e dhunës e që çdo vajzë të rritet duke u ndier e sigurt", theksoi kryeministri Kurti, duke shtuar se si përgjigje ndaj dhunës institucionet tona e kanë përmirësuar dukshëm kornizën ligjore me ndryshimet e fundit të 'përqaimit' të Konventës së Stambollit.

Ai shtoi se korniza ligjore, krahas avancimit, duhet shoqëruar me politika të duhura publike, rritje të cilësisë së shërbimeve publike, pavarësi ekonomike e financim të qëndrueshëm, andaj me qëllim të pavarësimit dhe fuqizimit ekonomik të grave, në këto dy vjet të qeverisjes janë ndërmarë hapa konkretë për një Kosovë sa më barazimtare mes grave dhe burrave.

Kryeministri Kurti tha se me



përkushtim institucional e shoqëror do të punojnë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, këtë fenomen shoqëror që pamundëson barazinë, sepse nuk mund të

ketë barazi shoqërore pa pasur edhe barazi gjinore. "Pabarazitë, padrejtësitë e paragjykimet duhet t'i luftojmë bashkë. Dhunën në familje e dhunën në bazë gjinore duhet ta luftojmë në

mënyrë efikase të gjithë, gjatë gjithë kohës e çdo kund. Do të jemi krah për krah, drejt barazisë gjinore, që është parakusht për një shoqëri të barabartë", tha kryeministri Kurti.

Komunat po aplikojnë kërkesa shumë të larta diskriminuuese në dosje të tenderëve

PRISHTINË, 29 MARS - Organizata Iniciativa për Progres (INPO), në kuadër të projektit "Kërko drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë", me mbështetje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë Ndërkombëtare për Çështje të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL), të mërkurën nëpërmjet konferencës për medie ka publikuar raportin me titull "Procesi i prokurimit dhe menaxhimi i kontratave 20 komuna".

Qëndrim Arifi, hulumtues i lartë në INPO, hapi konferencën duke treguar përmbajtjen e raportit dhe metodologjinë që ka ndjekur INPO gjatë procesit të monitorimit.

Arifi theksoi se raporti përfshin monitorimin e më shumë se 80 tenderëve dhe ky raport brenda vetes përmban edhe komentet e komunave të fokusit. Pas kësaj, me qëllim të prezantimit të gjetjeve të raportit, fjala u kalua te hulumtuesja e INPO-s, Leoreta Alija.

Alija potencoi se rezultatet e hulumtimit tregojnë se

përkundër obligimit me dispozita të caktuara ligjore që tenderët e iniciuar të jenë të parashikuar me plan të prokurimit, AK-të, përkundër një përmirësimi nga viti i kaluar, ende vazhdojnë t'i shkelin këto dispozita.

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se komunat janë duke aplikuar kërkesa shumë të larta, joproporcionale, diskriminuuese dhe jovalide në dosje të tenderëve.

Konkretisht, 7 nga 20 komunat e monitoruara kanë aplikuar këto kërkesa, ndërsa gjashtë 6 komuna të tjera kanë larguar kërkesat joligjore pas reagimeve dhe rekomandimeve të INPO-s. Një dukuri mjaft shqetësuese gjatë zhvillimit të procesit të prokurimit është përdorimi i shpesh të formularit B54 për korrigjimin e gabimeve në dosjen e tenderit, konkretisht në 9 nga 20 komunat e monitoruara janë evidentuar këta formularë të cilët janë tregues të qartë për lëshime dhe joprofessionalizëm në hartimin e dosjes së tenderëve.

Alija theksoi se komunat janë



duke e keqpërdorur mundësinë ligjore për shkurtim të afateve për pranimin e tenderëve. Në fakt, 7 nga 20 komunat e monitoruara kanë shkurtuar afatet për pranimin e tenderëve duke ndikuar në numrin e OE-ve të cilët ofertojnë dhe në cilësinë e ofertave të pranuar. Më tutje, hulumtimi vë në pah se si komunat për shërbimin e njëjtë paguajnë çmime të ndryshme prej vitit në vit, ndërsa

krahasuar me komunat e tjera çmimet janë diametrisht të kundërta. Më tutje, në pesë komunat e monitoruara INPO ka evidentuar raste kur anëtarët e komisioneve për vlerësim të tenderëve nuk kanë pasur profesion as të përafërt me natyrën e kontratës që nënkupton se nuk kanë pasur kapacitet profesional për vlerësim të tenderëve. Përveç kësaj, janë evidentuar edhe raste

kur tenderët janë vlerësuar nga persona të paautorizuar.

Sa i përket aspektit të menaxhimit të kontratave, rezultatet e hulumtimit tregojnë se disa komuna, përkundër obligimit ligjor dhe thirrjeve të vazhdueshme nga KRPP, nuk publikojnë kontratat në platformën e-prokurimi. Kjo shkelje ligjore është evidentuar në 5 nga 20 komunat e monitoruara.

Gastronomia dhe hoteleria paguajnë 117.08 për qind më shumë tatim



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 MARS - Monitorimi i fokusuar i hotelerisë / gastronomisë dhe funksioneve që lidhen me to, si këngëtarëve, stilistëve etj., ka nisur përmes projektit specifik për përmbushje tatimore në vitin e kaluar. Ky projekt ka dhënë rezultatet e veta në trajtimin e sektorëve të lartcekur, të cilët në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës kanë paraqitur nivel të konsiderueshëm të riskut.

Thirrjet e shpeshta nga ATK-ja për t'i përmbushur detyrimet dhe puna në terren kanë rezultuar që statistikën nga ky sektor të jenë në një nivel të kënaqshëm, duke filluar nga qarkullimi i deklaruar me 24.24 për qind ose 64 milionë euro, pagesa 117.08 për qind ose 10 milionë euro dhe numri i punëtorëve 14.45 për qind ose 2 820 punëtorë më shumë se në

vitin e kaluar, pastaj duke vazhduar me gjetjet nga terreni, si qarkullimi shtesë nga vizitat me dallim enorm prej 321.95-përqindësh më shumë se vitin e kaluar.

Dihet që në sektorin e gastronomisë dhe hotelerisë, përveç atyre që u përmendën, si dukuri e cila mbetet ndër faktorët kyç të informalitetit janë edhe punëtorët e padeklaruar, e kjo është dëshmuar edhe nga puna e inspektorëve, të cilët për 2022-n kanë formalizuar 111.84 për qind punëtorë më shumë se vitin e kaluar. Ajo çfarë vlen të potencohet është se ky sektor prin me statistika sa i përket fiskalizimit, por mbetet sfida lëshimi i kuponëve fiskalë. Projekti për përmbushje tatimore në hoteleri dhe gastronomi, si dhe në zinxhirin e tyre bashkëpunues, do të vazhdojë të implementohet me qëllim të formalizimit plotë të aktivitetëve.

Projektligji i ri për mbrojtjen e konsumatorit synon t'i mbrojë të drejtat e tyre

PRISHTINË, 29 MARS - Me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje të konsumatorit synohet të mbrohen të drejtat e konsumatorit, duke ofruar nivel të dëshirueshëm të produkteve dhe siguri të tyre. Kështu u tha në debatin publik që Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka mbajtur për këtë projektligj.

Anëtarë i këtij Komisioni, Driton Hyseni u shpreh se përmes këtij

diskutimi publik u ofrohet mundësi që të gjitha palët të japin komentet e tyre që do të futen pastaj si amendamentet. "Ligji i ri që do të miratohet i adreson në mënyrë adekuate me qëllim që interesi i konsumatorit të jetë në nivel të dëshirueshëm aty ku e ka vendin, sepse ne mendojmë që e kemi për obligim edhe si deputetë, por edhe ju zyrtarë dhe organizata, që të japim kontribut maksimal që konsumatorit t'i mbrohet e drejta

e tij dhe do të bëjmë maksimumin që konsumatorët të jenë të kënaqur me atë që ligji i cili do të miratohet në Kuvendin e Kosovës do të prodhojë terren. Pra, një nivel të dëshirueshëm të produkteve, një siguri të produkteve që u prodhohen në vend, por edhe një nivel të shërbimeve konform kontratave që ata nënshkruajnë qoftë me autoritetet publike apo ndërmarrjet private", ka thënë Hyseni.



AJAZ EMINI - Ditar (VI)

NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

Që të gjithë që ishim menduam se mos ndoshta si surprizë paska ardhë që të na vizitojë në teren Lt. Gjenerali John J. Hendrix, i cili ishte personi kryesorë që po udhëhiqte Ushtrinë Amerikane në Shqipëri. Pas stopimit tonë, që të dy helikopterët u lëshuan nja 50 metra largë nesh, në shtratin e gjërë me rërë të lumit aty për anësh ku po kalonte një vadë uji, mu në krahun e majtë të rrugës. Meqenëse me ne ishte edhe Koloneli i Armatatës Amerikane Kol.Hannes, menduam gjithashtu ndoshta paskan ardhë që ta marrin kolonelin, sepse na kishte ndodhë edhe më parë, kur ai ishte me ne dhe nga një herë vinin edhe e merrnin atë me helikopter prej rruge. Kishim mendime të ndryshme për derisa zbriti kapiteni jonë Lerner në shtratin e lumit afër helikopterit për të parë se pse kishin ardhë aty. Meqenëse ishim në dalje të qytetit, shumë prej qytetarëve u mblodhën. Po, më tepër nga kurioziteti për të parë se ç'po ndodhëte. Unë isha ai që gjithëmonë isha në front me popullatën lokale për t'i sqaruar se pse ishim aty, apo se ç'po bënim, apo ç'po ndodhëte aty. Për derisa unë po bisedoja me popullatën lokale dhe po i sqaroja se helikopterët erdhën për ta marrë kolonelin që ishte me ne. Ende pa iu afruar kapiteni ynë, kur po në të njëjtën kohë prej së largu në distancë 20-30 metra m'u drejtua mua njëri që zbriti nga helikopteri e që ai ishte Kapiteni Walter J. Wiggins, i Forcave Speciale të Armatës Amerikane, e që më vonë ai do të ishte personi me të cilin do të bashkëpunoja në të ardhmen. Ai më pyeti se a jamë unë përkthyesi CAT 2 (shifra e përkthyesve amerikanë të pranuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan)? Unë përmenjëherë ia ktheva "Po, unë jamë CAT 2", atëherë ai më tha "Të lutem shko merri gjërat e tua që i ke në makinë dhe eja me ne, dhe përsëri më tha: "Gjithashtu i thua edhe përkthyesit tjetër, kolegut tuaj CAT 2 të vijë me ne" e që ishte në të njëjtin konvoj ushtarak por me grupin që kishte mbetë disa makina më mbrapa nesh. E thirra kolegun tim i cili quhej Muhamed Blakaj, me të cilin nuk njëfeshim mirë, i cili ishte me prejardhje nga Peja, por që jetonte në shtetin e Connecticut (Konektikat). Që të gjithë mbetëm të habitur, sepse nuk dinim se ç'po ndodhëte me ne sepse nuk kishim kurrëfarë paralajmërimi. Së bashku me plaçkat tona mbi supe u nisëm drejtë dy helikopterëve të ndalur në zhavor mbi shtratin e lumit. Kapiteni Lerner që ishte me mua u revoltua tepër shumë, dhe filloi të shajë dhe të pyes vetëveten në zë se pse erdhën me na marrë neve? A nuk paskan pasë përkthyes të tjerë por me ardhë këtu, tani kishim bërë një shoqëri të mirë dhe mbi të gjitha kishte besim të madh në mua edhe kishim marrëdhënie shumë të mira me to. Deri sa ne po largoheshim në drejtim të helikopterëve, gati se e



20 Qershor 2000, Sojevë /Kosovë, Ajaz Emini me Gjeneralin e UÇK's Agim Cekun

gjithë kompania Bravo dhe kapitenët Lerner dhe Roadcap na uruan rrugë të mbarë dhe kthim sa më të shpejtë në njësitë e tyre! Tani për derisa neve po i afroshim helikopterëve, i gjithë grumbulli i popullatës nga Puka që ishin për rreth neve, mbetën disi të habitur. Po, se unë para disa minutash po i spjegoj se helikopterët erdhën për të marrë kolonelin, tani ata ndoshta po mendonin se në të vërtetë paskan ardhë që të marrin shqiptaro-amerikanët, diçka që në të vërtetë edhe ishte ashtu sepse ata erdhën për të na marrë neve! Për mua personalisht ky ishte fluturimi im i parë me helikopter, për çka isha mjaft kurioz, por edhe diçka që s'e kisha provuar asnjëherë më parë. Në të hyrë mbrenda u njoftuam me ekuipazhin e helikopterit, dhe pasi u ulëm menjëherë na dhanë të vejmë ndëgjionjëse në veshë. Ata ishin për bllokimin e zhurmës së rotorëve të helikopterit, për të mbrojtë shqisat e ndëgjimit gjatë fluturimit. Me helikopterë menjëherë u ngritëm lartë në ajër, rreth 50-60 m.lartësi dhe filluan lëvizjen e fluturimit drejtë luginës së shtratit të lumit në drejtim të kodrës në rrafshlartën mbi ne ku kishim vënë bazën tonë. Fluturimi ishte mjaftë interesant, i shpejtë dhe me luhajtje të shumëta nga njëra anë në tjetrën sipas lakesave të lumit. Ky fluturim më përkujtonte ditët kur shkonim me familje në parkun e luhatëseve, që ishte rreth një orë largë nga shtëpia jonë në Ohio, në vendin e quajtur Cider Point. Ky është ndër parqet më të njohura në botë, ku janë luhatëset më të mëdha të botës që të bënin luhatjet nga një anë në anën tjetër dhe në shpejtësi tepër të madhe dhe shumë trishtuese që të ngritë adrenalinën në kupë të kokës! Gjatë rrugës deri tek baza jonë në krahun tim të djathtë ishte kolegu im Muhamed Blakaj i cili filloi të më irritojë pa masë, duke më thënë dhe në të njëjtën kohë edhe duke më bërë

pyetje: "Ku po na çojnë, unë nuk kam ardhë këtu për të luftuar, unë nuk shkojë në vijën e parë të frontit..." etj, etj., Dikur nuk m'u durua më edhe i thash: "Po ore burrë, çka paske mendu, se a mos kemi ardhur këtu në pushime? Ne jemi këtu për të shërbyer dhe me ndihmuar gjithëkund ku është nevoja, po nëse duhet dhe është nevoja do të shkojmë dhe në vijën e parë të frontit. Po, atje ku po luftohet, atje ku po derdhet gjaku, atje ku po vdesin edhe më të dashurit tanë! Po s'deshte të vishë thuaj këtyre, thuaj kapitenit tani edhe menjëherë do të rregullojnë kthimin prej nga ke ardhur, e mos më çajë kokën me kopallat e tua!" Meqenëse nuk ishim largë nga baza jonë ushtarake mbrenda disa minutash fluturimi arritëm në vendin tonë të caktuar, aty ku po na prisnin dy Humvee të blinduara ushtarake, si dhe një kamion me policë ushtarak të Ushtrisë së Republikës së Shqipërisë. Po me të cilët i kishin caktuar që të na shoqëronin në udhëtimin tonë të më tejme, për në qytetin e Kukësit. Tani grupi ushtarak me të cilin neve do të shkojmë ishte Njësia Speciale e Ushtrisë Amerikane, ku ky ishte një ekip ndërlidhës (LeisonTeam) të cilët ishin përcaktuar që të bashkëpunonim me Gjeneralin Kudus Lama nga Komanda e Ushtrisë së Shqipërisë, nga kazërma e tyre në Kukës. Bashkëpunimi ynë me Gjeneralin Kudus Lama të Shqipërisë kishte për qëllim lehtësimin e marrjes së informatave sa më të sakta nga grupi vëzhgues i UÇK-së të komanduar nga Gjenerali Agim Çeku, për objektivat e vendëndodhjes dhe lëvizjeve të forcave të armikut serb. Ne me këto informata do t'ia lehtësonim punën pilotëve të aviacionit të NATO-së për caqet më të përpikëta të bombardimeve të tyre në mbrendësi dhe rreth Kosovës. Po, kjo po bëhej për shkak të burokracisë së OKB'së që nuk

lejonte që siç ishim ne pjesëtarët e NATO's që të kishim lidhje direkte me shtabin e pjesëtarëve të ushtrisë së UÇK- së.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Më 16 Maj kishin intervistuar edhe dëshmitarin për rastin e bombardimeve në Korishë, ishte një refugjat kosovar i cili tha për DeutscheWelle se forcat policore jugosllave kishin marrë rreth 600 refugjatë për t'i përdorë si mur i gjallë për rreth forcave të tyre serbe, para se të sulmoheshin nga bombarduesit e NATO-së. Para se të ndodhë incidenti policia iu kishte thënë refugjatëve; "Se po që se ikni ju prej këtu do t'ju ndodhë diçka shumë e keqe". Policia Serbe iu kishte thënë edhe këtë: "Tani do të shifni se çka është sulmi i NATO-së, dhe pas sulmit për derisa refugjatët kishin fillu që të ikin, forcat serbe kishin gjuajtur me armë të ndryshme mbi to..."

BASHKANGJITJA IME NË NJËSINË E FORCAVE SPECIALE TË ARMATËS AMERIKANE DHE BASHKËPUNIMI YNË ME GJENERALËT: WESLEY KANNE CLARK KOMANDANT SUPREM I NATO'S, GJENERALIN JOE WALTER HENDRIX (ARBËRESHO/AMERIKAN) TË ARMATËS AMERIKANE NË SHQIPËRI, ME GJENERALIN KUDUSI LAMA KOMANDANT I DIVIZIONIT TË KËMBËSORISË NË KUKËS TË USHTRISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, I CILI ISHTE EDHE NDËRLIDHËSI YNE KRYESOR ME LT. GJENERALIN E UÇK'S AGIM ÇEKUN

Gjatë rrugës për në Kukës me Njësinë e Forcave Speciale të ardhur nga baza amerikane e Boblingenit të Gjermanisë, e që këto janë pjesë e Armatës së Shteteve të Bashkuara, morëm rrugën për në qytetin e Kukësit për

të takuar Gjeneralin Kudus Lama, Komandant i Divizionit të Këmbësorisë në kazermën ushtarake të Kukësit. Me këtë njësi tani sapo e filloja punën e re. Gjatë udhëtimit disa orësh nga malet e Pukës për në Kukës, ne nuk patëm aq shumë bisedë, sepse së pari ende nuk njëfeshim aq mirë në mes veti. Pasi kaluam Pukën, vazhduam rrugën për rreth kazermës ushtarake të UÇK-së që e kisha parë një ditë më herët. Aty po shiheshin duke u valvitur flamujt si: ai kombëtarë dhe përkrahë tij edhe ai i UÇK-së para hyrjes në kazermë, aty ku po qëndronte edhe roja e UÇK's.

Për një çast u ndalëm në rrugën kryesore për në Kukës për ku po udhëtonim, u ndalëm përballë kazermës së UÇK-së, e ku njëri nga pjesëtarët e Njësisë së Forcave Speciale me të cilët isha edhe unë, doli nga makina edhe i bëri disa fotografi kazermës së UÇK-së. Ai po në të njëjtën kohë nxorri edhe koordinatat e kazermës! Ky lloj akti, disi më iritoi mua personalisht, ishte diçka që nuk më pëlqeu aspak në pamje të pare. Në fillim po mendoja në vete a mos janë këta njerëz ndonjë ekipë spiunazhi, sepse secilën lëvizje që bënin në pamje ishin shumë profesionale, por shumë të dyshimtë për mua! Filloi një dyshim i madh në mua, dhe gjatë rrugës shpeshëherë po i bëja pyetje vetes se a thua në cilin krah na qenkan këta ushtarak me uniformë amerikane? Nuk m'u durua më dhe pas disa minutash iu drejtova edhe e pyeta Kapitenin Walter J. Wiggins i cili ishte edhe përgjegjës i grupit: "Zotëri kapiten ç'po bëjmë ne, pasi se po iu shoh se për momentin ju më tepër po merreni me informata se ku gjendet UÇK-ja dhe pozicionet e tyre? Disi nuk po iu kuptoj për tani se ku po shkonim edhe pse po shkonim?" Kapiteni Walter J. Wiggins m'u përgjigj: "Koordinatat e UÇK-së që i morëm më herët na duhen neve, sepse në të kaluarën neve të ushtrisë amerikane na ka ndodhë kur forcat aleate na u kanë kthi në forca armike, dhe për atë ne duhet që gjithmonë të jemi të gatshëm për çfarëdo situatë që na paraqitet në të ardhmen. Ne jemi këtu aleatë të UÇK-së, dhe jemi që të ndihmojmë popullin shqiptarë dhe forcat e UÇK-së me bombardimet tona të NATO -së. Me ndihmën e ndërmjetësuesit tonë Let. Gjeneral Kudus Lama të Ushtrisë së Shqipërisë, do ta lehtësojmë këtë punë duke e bërë edhe shumë më të suksesëshme, atje nga kazërma ushtarake e Armatës së Shqipërisë në Kukës!" Distanca nga vendqëndrimi ynë ushtarak amerikan afër Pukës deri në Kukës kishte rreth 50km., ishte një rrugë jo aq e mirë, dhe me ndalesat që bëmë na zgjati rreth dy orë udhëtimi. Gjatë rrugës takuam edhe disa kamionë ushtarak të Armatës së Shqipërisë, e që po bartnin disa tanke dhe me disa lancues raketash, të ngajshëm me raketë lancuesit Katyusha të

Rusisë e të cilët po lëviznin ngadalë dhe me vështirësi në drejtim të qytetit të Kukësit! Gjatë rrugës gjithashtu takuam edhe disa kolona me traktorë dhe me qerret e kapura për mbrapa. Qerret ishin të mbushura me gra, pleq dhe fëmijë, që në fytyrat e të cilëve shihej qartazi maltretimi dhe vuajtja e tyre. Ishin pamje të cilat po ma këpusnin shpirtin. Ishin refugjatët shqiptarë nga Kosova, të cilët kishin marrë destinacion të pa ditur, vetëmse për të shpëtuar jetërat e tyre...

Në kazermën kryesore të Ushtrisë së Shqipërisë në Kukës mbërritëm vonë në mbrëmje, dhe në hyrje të sajë kishte dalë që të na presë edhe vetë Gjenerali Kudusi Lama, me disa eprorë të tjerë ushtarak.

Në takimin tonë të parë, Gjenerali Lama na njoftoi me secilin prej ushtarakëve të tij veç e veç, duke na i treguar emërat, gjithëashtu dhe pozitën e tyre ushtarake që kishin në Ushtrinë e Shqipërisë. Meqenëse ne ishim pakë të lodhur nga udhëtimi, nuk e zgjatëm aq shumë, i kërkuam që të na udhëzojë për në vendin tonë të pushimit, e cila ishte një dhomë në katin e dytë të kazermës. Dhoma ishte një sallë e madhe në ndërtesën kryesore të kazermës ushtarake të Kukësit, kazermë e cila ishte thujse krejtësisht e zbratur dhe nuk pamë shumë ushtarë rreth sajë!

Në dhomën lartë të katit të dytë ku do të kalonim natën, me vete morëm edhe të gjitha teshat tona që kishim në automjetet tona e që i parkuam përballë godinës që ishim.

Me vete kishim thasët tonë të mbushura me veshëmbathje, si edhe disa arka të mëdhaja të cilat poashtu ishin plotë me materialet e ndryshme ushtarake.

Në njërin prej tyre, kishim thujse një ambulante të plotë me medikamente, barna dhe mjete tjera sanitare të mjekësisë, kurse në arkën tjetër kishte armatime të llojeve të ndryshme si: një pushkë e gjatë snajper, disa lloje bombash dhe disa armë të tjera automatike. Pas zbakimit të sendeve tona që kishim, hangrëm darkën dhe më pas para se të bëheshim gati për gjumë, Kapiteni Wiggis e urdhëroi njërin nga pjesëtarët e Njësisë tonë Speciale, që të më spjegojë përdorimin e armatimit që kishim, e që në rast të ndonjë rreziku eventual të kemë edhe unë njohuri se si t'i përdorë ato!

Kolegu im i Forcave Speciale, spjegimin e filloi me armën më të gjatë që kishim aty, pra snajperin (American Sniper) e për të cilën më tha se snajperisti i mirë me këtë armë mundë të gjuaj dhe qëllonjë deri në 5 km. distancë, mirëpo në 3.5 km. mundë të bëjë vrasje të sigurtë, pastaj vazhdoi me demonstrimin se si punohet me revolen ushtarake që ata po bartnin, pushkën automatike M16, si dhe disa lloje bombash dore që ishin aty. Më thanë se më e rëndësishmja mbi të gjitha ishte njëra bombë e cila do të përdorej në rast të tërheqjes nga zona e armikut, e cila ishte për shkatërrimin (djegëjes) të gjithëçkafit që posedonim, me qëllim që mos t'i binte asgjë në dorën e armikut!

Ishte një demonstrim shumë i rëndësishëm dhe i mire për mua,

por ishte edhe e pa mundur që në të gjitha ato armë të mbahet në mendë se si të përdoren, e sidomos për mua që asnjëherë nuk kisha qenë aq entuziast i armëve! Në përfundim të kursit për mësimin e përdorimit të këtyre armëve m'u afrua edhe Kapiteni Wiggis edhe më tha: "Këto mësimet i ke, që në rast të rrezikut, edhe pse ne jemi të obliguar që me çdo kusht së pari të mbrojmë ty, e pastaj veten, por në raste të veçanta edhe ti duhesh që të dishë të mbroshë veten dhe të na ndihmosh edhe neve, sepse ne të gjithë jemi për njëri tjetrin. Ne për ty, e ti për ne!" Pas kryerjes se këtij mësimi dhe bisede, secili prej nesh shkuam dhe pastruam të gjithë pluhurin e rrugës së gjatë që kishim marre nga Puka për në Kukës. Pastaj nxorrëm thasët tonë të gjumit edhe u shpërndamë secili qosheve të sallës, ku edhe e kaluam natën me fjetje shumë më të rahatëshme se në çadrat ushtarake të deritanishme që kisha patur.

Ngjarjet e 24 orëve të fundit;

Forcat e aviacionit të NATO-së për sot ishin të fokusuar kundër forcave serbe në jug dhe juglindje të Kosovës, veçanërisht në rajonin e Junikut, Prahovë, Boljevac në veri të Rugovës dhe në Prishtinë. Gjatë këtyre sulmeve forcat e NATO-së qëlluan 6 tanke, autobllinda, armët artilerike, automjete ushtarake, qendrat ushtarake, depot ushtarake si dhe postet e kontrollit dhe komandës. U qëlluan mortajat dhe automjetet ushtarake në afërsi të Serbicës, artileria dhe autobllindat në afërsi të Deçanit dhe Prizrenit, koncertimi i artilerisë afër Ferizajit si dhe ushtarët dhe automjetet ushtarake serbe në afërsi të Shtimes. Në Kosovë u sulmuan edhe radio rrethit ushtarak në Ferizaj dhe autostradat në lokacionet e ndryshme, kazerma ushtarake dhe posti komandues në Prishtinë.

Gjatë ditës së djeshme NATO sulmoi edhe trafat e furnizimit elektrik në Smederevë si dhe fabrika e hekurit dhe çelikut në Borsi dhe rafineria.

E hënë 17 maj 1999

Që të gjithë pjesëtarët e njësisë që ishim u zgjuam dikur rreth orës 8:00 të mëngjesit, koha ishte e bukur me diell por e freskët. Pasi u zgjam erdhi Gjenerali Kudusi Lama, dhe na thirri që të shkojmë për të parë objektin ku do të qëndronim deri në fund të fushatës së bombardimeve të NATO's, deri në fund të bashkëpunimit nga qyteti i Kukësit të Shqipërisë. Na mori dhe shkuam që të gjithë së bashku në objektin e Policisë Ushtarake të Shqipërisë. Ky objekt ndodhej në një distancë prej ku ishim rreth 2 km., atje ku do të na e rregullonin edhe një banjo me ujë të nxehtë, e cila na kishte munguar që nga ardhja ime në Shqipëri e që ishte një ekskluzivitet për ne, sepse gjerë më tani ishim mësuar që të pastroheshim vetëm se me ujë të fohët!

Paraditën e kaluam mbrenda dhe jashtë Kazermës së Policisë Ushtarake të Kukësit, duke bërë



23 Nëntor 1999, Sojevë /Kosovë, Shahadija me Sekretaren e SHBA's Madeleine Albright në Kampin Ushtarak Amerikan "Bondsteel", Sojevë

planifikimin se cilën dhomë do të shfrytëzonim për punë, e cilën për gjumë, si dhe paradržomën që kishim mendonim që do ta shfrytëzonim si odë e ndejës. Kuptohet edhe për pritjen e mysafirëve!

Derisa ne po vazhdonim me planet tona të ardhëshme, Gjenerali Lama na kërkoi falje edhe u kthye në punën e tij në kazermën kryesore, atje ku kaluam natën e parë në Kukës.

Në këtë objekt, neve na u lanë në shfrytëzim dy dhoma, një për punë, kurse tjetrën për të bërë gjumin. Disa metra më tutje, kishim edhe banjon tonë private, kurse në anën tjetër të kundërt po të njejtë objekt ishin edhe zyrat ku po punonin Policia Ushtarake e Shqipërisë në këtë qytet.

Në oborrin që kishim përballë nesh, kishim disa istikame të mëdha prej betoni nën tokë, e që ndoshta ishin të ndërtaura nga koha e Xhaxhit Enver, kurse përpara neve në krahun e djathtë ndodhej një magazinë, e ku po qëndronte në këmbë një rojtar i shtyrë në moshë, me uniformë të UÇK-së, e që tërë kohës po i sillej rreth e rrotull atij objekti!

Në orën 13:00- gjatë ditës së sotme, kishim edhe takimin e parë zyrtarë të punës me Komandantin e Divizionit të Këmbësorisë së Armatës së Shqipërisë në Kukës, Gjeneralin Kudusi Lama në zyrën e tij. U niëm nga vendqëndrimi ynë i ri që do të kemi, për në zyrën e Gjeneralit Lama, rrugë e cila na zgjati 15-20 minuta në këmbë. Në të arritur para kazermës ushtarake na pritën roja e cila menjëherë e telefonoi Gjeneralin Lama për ta lajmëruar për ardhjen tonë, e siç dukej Gjenerali menjëherë e urdhëroi rojen që të na lejonin të shkojmë të lirë për në takim në zyrën e tij. Zyrja e Gjeneralit ndodhej në katin e dytë të godinës ku po hynim.

Para zyrës së Gjeneralit takuam rojen e tij personale pranë një tavoline të vogël që kishte anash, i cili me të shpejtë e lajmëroi

Gjeneralin Kudusi Lama për arrijten tonë.

Mikëpritja e Gjeneralit shqiptar ishte e ngrohtë dhe shumë miqësore. Derisa po përshendeteshim me të, ai menjëherë e porositi truprojen e tij që po qëndronte para derës së zyrës, që të na bëjë nga një kafe turke si dhe të na sjellë nga një dolli raki rrusi që dikush tjetër sapo ia kishte sjellur atij.

Gjenerali Kudusi Lama ishte në moshën mesatare, ndoshta ishte për disa vite më i vjetër se sa unë. Kur u takuam ne për herë të parë me të, ai sapo i kishte mbushur të 48'at. Ishte në uniformën ushtarake me shtat dhe peshë mesatare, si dhe fizikisht mjaft i zhvilluar. Kishte flokë të dendura të shkurtëra e të zeza, dhe me një fytyrë me tipare të burrisë së lartë dhe me shumë zemër e ngrohtësi.

Gjenerali Kudusi Lama, në fillim na spjegoi për karrierën e tij ushtarake, na tregoi se më herët para disa vitesh kishte qenë Shefi i Artilerisë së Brigadës së Këmbësorisë në Kavajë, dhe pastaj ishte transferuar këtu në kazermën ushtarake të Kukësit, dhe tani kishte fituar gradën e Komandantit të Divizionit të Këmbësorisë të zonës kufitare këtu në Kukës.

Që në fillim të bisedës edhe Gjeneralit i interesoi të dijë pakë më tepër edhe për ne, se kush ishim dhe çka ishim? Pas prezentimit të secilit prej nesh veç e veç, filluam edhe temën kryesore të bisedës për çka kishim ardhur edhe ne këtu nga Njësitë e Forcave të Armatosura Amerikane, si dhe rreth detyrës që do të ndërmerrim së bashku me të gjatë ditëve të ardhëshme.

Zyreja e Gjeneral Kudusi Lama ishte e përmasave të vogla, e thjeshtë, por me dekor të bukur dhe mjaft komode. Kishte një tavolinë të gjatë, e mbi të cilën qëndronin disa libra dhe fletore të punës. Në skajet e saja kishte të vendosur një flamur të vogël

kombëtarë por dhe shtetërorë të Shqipërisë. Në njërin anë kishte një karrike, e kurse përballë në anën tjetër ishte një karrike tjetër. Pas arrijtes tonë aty, truproja e tij i cili ishte një ushtarë i ri, na e solli edhe një karrike shtesë, kurse prapa shpinës së Gjeneralit ishte një skaf ku ishin të renditura disa libra dhe dekorime. Më lartë në murë ishte e vendosur fotografia e Presidentit aktual të Shqipërisë Rexhep Mejdani, kurse anash në murin e hapur kishim flamurin kombëtarë shqipëtarë. Në skajin tjetër të tavolinës kishte edhe një kompjuter. Pas dere kishte të varur armën e tij personale që ishte një Kallashnikov, e kurse në anën tjetër të derës kishte një tavolinë të vogël me një televizor 19 inç, në të cilin gjatë asaj kohe ishin lajmet e ditës të televizionit shqipëtar.

Gjatë bisedës sa ishim mbrenda, u ndëgjua një thirrje telefonike në telefonin e zyrës që ndodhej mbi tavolinën e Gjeneralit, i cili në fillim na kërkoi falje edhe iu përgjigj thirrjes. Gjenerali bisedën e filloi me një zë të ulët, mirëpo pas një kohe të shkurtë filloi ta ngrisë zërin e tij, e më vonë kaloi në ekstrem duke iu kërcënuar personit në anën tjetër të telefonit me fjalët: "Poqëse vazhdon ashtu, edhe do të përzejë nga puna, nëse nuk i përmbahesh urdhërave të mia", dhe ashtu i nevrkosur ia mbylli telefonin!

Pastaj bisedën e vazhduam për sulmin që iu ishte bërë Shqipërisë, 500 metra në mbrendësi të kufirit shqipëtarë, nga forcat paramilitaro-ushtarake serbe! Këtij sulmi Forcat e Ushtrisë së Shtetit Shqipëtarë iu kishin përgjigj me kundërsulm, ku kishte patur disa të vrarë dhe të plagosur nga forcat e ushtrisë serbe, të cilët menjëherë ishin zbrapsur dhe kishin ikur nga ky sulm! Pastaj vazhduam edhe me bisedën rreth shkëmbimit të informatave që do të na vinin nga Njësia e Vëzhguesve të Intelgjencës Shqipëtare, nga Njësia Vëzhguese e UÇK-së, si dhe

asaj amerikane nga mbrendësia e Kosovës. Kështu që aksioni i bombardimeve të avionit të NATO-së të ishte sa më i saktë, më i shpejtë dhe më i suksesshëm, në arritjen e qëllimeve të forcave të NATO-së dhe UÇK-së, për shkatërrimin dhe eliminimin e plotë të forcave të armikut serb! Gjenerali Lama siç na tha, ai kishte informatat e shumëta dhe të sakta në lidhje me lëvizjet e trupave paramilitare ushtarake policore serbe, si përgjatë kufirit Shqipëri-Kosovë, si dhe përgjatë terrenit përbrenda Kosovës.

Biseda ishte e gjerë, gjithashtu u tha se për gjithëçka që po flisnim dhe do të veprojmë, të mbetej konfidenciale! Shkëmbimi i këtyre informatave në mes nesh dhe Gjeneralit Lama, duhen që menjëherë t'i përcjelleshin Let.Gjeneralit John W. Hendrix në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave Amerikane në Rinas Tiranë, i cili ishte edhe personeli kryesorë për Forcat e NATO –së mbrenda Republikës së Shqipërisë. Gjenerali Hendrix ishte personi që sa t'i merrte informatat tona, duhej që pa kurrëfarë vonese t'ia jepte Komandantit Suprem të Aleancës së NATO-së në Bruksel, Gjeneralit Wesley Clark, i cili ishte edhe Komandanti "Operacionit të Forcave A l e a t e" të NATO-së për Europë, nga i cili jepeshin urdhërat për sulmin e bombardimit të objektivave mbi forcat paramilitare ushtarake policore jugosllave në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi.

Gjenerali Kudusi Lama sapo ishte takuar një ditë më herët me Lt. Gjeneralin Joe W. Hendrix në Bazën Amerikane të Rinasit, ku edhe kishin biseduar në lidhje me planet e bashkëpunimit të ardhshëm, për të cilin edhe ne tani jemi këtu.

Bisedimet e sotme në mes nesh ishin të frytëshme dhe mjaftë shpresëdhënëse! Pas bisedës shkuam që të pijmë nga një kafe turke në kafiterinë e shtabit që e kishin aty, dhe më vonë u ndamë nga Gjenerali Lama për të ikur në dhomën tonë në kazermën përballë ku po qëndronim: unë AjazEmini, Kapiteni Walter J. Wiggis, Brian (mjek), John (radio-lidhjet), Dave (inxhinjeri), Mike (mekanik) dhe Rob (vëzhgues) që të gjithë të Njësisë së Forcave Speciale të Armatës Amerikane të ardhur nga baza e Armatës Amerikane në Boblingen të Gjermanisë...

Informacionet e 24 orëve të fundit

Sot në Bruksel ishte mbledhja e Ministrave të Punëve të Jashtëme të Bashkësisë Evropjane në lidhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë së OKB-së për Kosovën, si dhe pritej edhe takimi i Presidentit të Malit të Zi Djukanoviç me liderin Ibrahim Rugova.

Për shkak të kohës së keqe, tre të katërtat e sulmeve të planifikuara për sot u anuluan. Aeroplanët e NATO-së sulmuan trupat dhe automjetet ushtarake në afërsi të Deçanit, si dhe artilerinë serbe në jug të Prizrenit.

Në 24 orët e kaluara bombarduesit e NATO-së bënë 343 fluturime, prej të cilëve 58 sulme ishin të përqendruara kundër mbrojtjes

ajrore serbe. Bombardimet kishin vazhduar mbrenda Kosovës si dhe në mbrendi të Serbisë duke qëlluar Rafinerinë "Jugpetrol" në Bor, termocentralin "Elektro Istok" në Zaječar dhe në disa qytete tjera. U qëllua rrethi i radios në Kopaonik si dhe ura në Oberva.

Nga përfaqësuesit e NATO's u tha se sulmet nuk do të ndalen përderisa Presidenti Serb Slobodan Millosheviq të pranojë kërkesat e NATO-së pa kurrëfarë kondite të komunitetit ndërkombëtarë: të ndalë vrasjet, të tërheqë armatën dhe forcat e policisë speciale, që të pranojë prezencën e trupave të sigurisë ndërkombëtare, që të lejojë kthimin e të gjithë refugjatëve pa kurrëfarë ndalese, dhe të punojë në marrëveshjen politike të Kosovës sipas marrëveshjes së Rambujesë (Rambouillet). Janë 5 kondita që duhet pranuar patjetër!...

E martë 18 maj 1999

Këtë ditë e filluam disi më me pakë obligime, nuk ishim aq të nxanun pasi se ishim në pritje të përgjigjes nga Let.Gjenerali Joe W. Hendrix të Shtabit të Armatës Amerikane në Rinas të Shqipërisë për kërkesat e dhëna nga Gjenerali Kudusi Lama, Komandant i Divizionit të Këmbësorisë në Kukës të Ushtrisë së Shqipërisë.

Gjatë ditës së sotme tek ne na erdhi në takim edhe një grup tjetër nga Njësia Speciale e Armatës Amerikane, të cilët qëndruan aty për një kohë të shkurtër, dhe pastaj që të gjithë së bashku shkuam për të takuar Gjeneralin Kudusi Lama, për të cilin i njoftuam edhe ato, edhe pse njëri prej tyre nga ai grup amerikan ishte pas njoftë prej më herët me Gjeneralin Lama. Në zyrën e Gjeneralit qëndruam deri në orën 13:00, prijta e të cilit ishte si çdo herë, e ngrohët dhe mjaftë miqësore, dhe kërkesat edhe për to ishin pothuajse të njehta sikurëse me neve. Duhej që pikë së pari edhe informatat e tyre të kalonin nëpërmes zyres tonë për t'iu dërguar Lt. Gjeneralit Hendrix, dhe dërgesa e informatave që të bëhen sa më shpejtë që është e mundur. Duhej që goditjet e caqeve të armikut serb të

ekzekutohen sa më shpejtë dhe sa më saktë. Më vonë ata të grupit tjetër të Njësisë Speciale, u nisën për të vazhduar për në pikën tjetër strategjike diku në Bajram Curr, e kurse edhe grupi tjetër që erdhi me ne dje, ata veçëse ishin vendosur menjëherë në Krumë, e që edhe ata ishin të angazhuar për mbledhjen e informatave tjera. Kjo po bëhej edhe me qëllim të vështrimit nga më afër rreth pikave kufitare me Shqipërinë.

Pas ndarjes nga takimi me Gjeneralin Kudusi Lama, unë me grupin tim vazhduam rrugën për në pazarin e Kukësit, për të blerë gjëra shtëpiake, pasi se tani po bënim shtëpinë tonë, dhe po na duheshin: enë gatimi, ushqime, kova plastike, sapunë dhe gjëra të tjera higjienike, si dhe shumë gjëra të tjera që na duheshin për gatime! Pazarin ishte larg neshë rreth 3.5 km, dhe me makinat ushtarake Hamvee arritëm për 10 minuta. Në Pazar kur arritëm, ishte pakë si vonë edhe shumë nga shitësit veçëse kishin ikur për në shtëpi, përveçëse disave që ende ishin në mbyllje e sipër. Pasi blemë shumicën e sendeve u kthyem për në shtëpinë tonë të re, vendë qëndrimin tonë, në Kazermën e Policisë Ushtarake të Shqipërisë.

Me të arritur në banesë, Kapiteni Wiggis e urdhëroi njërin nga pjesëtarët e grupit ushtarak të njësisë tonë që ishim, që të më manevrojë përsëri me armët që kishim me vete, ashtu që në rast të ndonjë rreziku që edhe unë të jemë sadopakë i aftë dhe i përgaditur në vetëmbrojtje, dhe ta kemë një dituri se si përdoren ato. E filluam me revolen e tij personale se si mbushet dhe si guhet me të. Pastaj vazhduam me pushkën e tij automatike M16, dylbitë me laser dhe me dritë shënjestër, granatë dore, hapjen e pushko-mitrolozitet që kishim. Pastaj vazhduam me armën kundër tankiste, disa lloje bombash dhe minave, bombëlave të gazit lotësjellës, bombë tymi me ngjyra të ndryshme, dylbi termike me të cilat mundë të shohësh trupat nga nxehtësia trupore e tyre, si psh.kur dikush fshihet pas muri, druri apo ndonjë objekti tjetër të ngurrët, me atë dylbijë mundë të shifet trupi i gjallë jo me

qartësi por forma e tij.

Ishte një orë e mire mësimi për mua që ia vlene shumë, sepse mundë të kishim rast të ndonjë rreziku. Epo dihet se jeta e njeriut është me shumë të pa pritura. Më vonë bëmë darkën, dhe me plan që në të ardhmen të fillojmë edhe me përgaditjen e disa gatimeve elementare, kush sa të dijë!

Tani meqenëse kishim rrymën elektrike në banesën tonë, në dallim nga çadrat ku ishim në terr e gjerë më tani, Gjenerali Lama na solli edhe një televizor, bile sa për të mundë që të informoheshim nga lajmet e ditës me risitë nga bota dhe rajoni.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë mëngjesit të sotëm u organizua takimi në mes të liderit Ibrahim Rugova dhe Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-së, i cili e njoftoi atë me 5 pikat elementare të kërkesës së NATO-së për të cilat nuk do të ketë kurrëfarë zbrapsje deri në përmbyllje të misionit.

Në 24 orët e fundit patëm 566 fluturime të NATO-së, prej 190 prej tyre, 62 ishin të drejtuara përsëri kundër mbrojtjes ajrore të armikut. Aeroplanët e NATO-së edhe pse ishte koha e keqe ata sulmuan me sukses 20 armë artilerike, pozicionet e mortajave, artilerinë kundërajrore, tanke, autoblanda si dhe automjete tjera ushtarake të Serbisë. Mbrëmë sulmet e NATO-së shkatërruan 3 helikopterë që po qëndronin në tokë në veri të Prishtinës, gjithashtu shkatërruan aeroplanët MiG-29, MiG-21 në aeroportin e Batajnicës si dhe një depo të raketave. U sulmuan edhe urat në autostradat: Popovac, Bare dhe Durakovac si dhe transmetuesi TV/FM në Kopaonik. Sot gjithashtu mbrenda Serbisë nga avioni i NATO-së u qëlluan edhe fabrika e municionit në Valevë dhe Krusik, dhe në Jasenicë, si dhe shumë objektiva të tjerë...

E mërkurë 19 maj 1999

Sot ishte ditë e bukur, mëngjesi ishte disi i freskët por më vonë koha u nxeh bukur mirë. Në orën 9:00 të mëngjesit, u nisëm dhe

shkuam në pazar për të blerë edhe disa gjëra shtëpiake për të cilat kishim nevojë.

Pazarin e gjetëm përplot me njerëz që po tregëtonin, si dhe takuam shumë refugjatë nga Kosova të cilët kishin mbushur rrugët e qytetit të Kukësit. Gjithkund ku hynim apo po kalonim neve si ushtarak amerikan, ishim në qendër të vëmendjes sepse dalloheshim nga të gjithë të tjerët, me automjetet e blinduara si dhe armatimin që po bartnin kolegët ushtarak. Gjithashtu edhe flamurin e Amerikës që po bartnim mbi supet e uniformës, na bënte për t'u dalluar nga të tjerët, por edhe bisedat tona në mes veti në gjuhën angleze ia tërheqnin vëmendjen njerëzve për rreth! Pazarin ishte i dendur dhe mjaftë i pasur, aty mundë të gjeje gjithëçka nga produktet ushqimore, veshëmbathjeve po edhe veglave të ndryshme të punës. Gjithkund nga shkonim dhe sillleshim me, po ndëgjoja bisedat e kurreshtarëve duke pëshpëritur, se ç'po kërkoni ne aty? Nga njëherë sa për t'ia thy kuriozitetin atyre që po pëshpërisnin, ia ktheja në shqip me ndonjë përhëndetje e që i bënte të habiten, se si edhe këta amerikanët tani po na flasin në ahqip! Dhe nga kurreshtja ma pritnin: "Hej vllaçko prej nga ju kemi?" Pasi se i tregoja se kush jam dhe prej nga po vija, ata përsëri menjëherë ma pritnin: "Po çka po pritni, kur do të hyni mbrenda në Kosovë?" ose "Pse nuk po i sulmojmë forcat serbe edhe prej këndeje kufirit?"

Pastaj unë duheshte t'i sqaroja; "Se asgjë nuk mvaret prej nesh, por nga ata që na kanë sjellur neve këtu! Ne jemi të gatshëm për çdo moment që të na kërkohet aktivizimi i sulmit". Me të gjithë ata që shkëmbenim ndonjë bisedë, që të gjithë na tregonin se ishin të kënaqur në veçanti me përkrahjen e shtetit të Amerikës që po i jepte Kosovës, si dhe me sukseset e bombardimeve që po bënin Forcat e Avionit të NATO-së mbi armikun serb. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin ata ndër të parët që çdo herë kishin ngritur zërin lartë për shqiptarët dhe Kosovën, edhe ishin ato që i kishin angazhuar edhe shtetet tjera të pakit të NATO-së që të ndërhyjnë me sulmin ushtarak në përkrahje të shqiptarëve kosovarë kundër sllavo-fashistëve serb.

Amerika ishte ajo që po bombardonte ditë e natë, me armatimet më të sofistikuar të tyre që kishin në dispozicion, mbi pozicionet paramilitare ushtarake policore serbe gjithë andej Kososovës, si dhe në mbrendësi të Serbisë! Gjatë tregëtimit, kur shikonim ndonjë send për të blerë, shpeshëherë vinin njerëzit e panjohur, edhe na përshëndetnin dhe na uronin mirëseardhje duke na dhënë urata të ndryshme si: "Zoti ju ruajt, sepse ju jeni drita jonë! Ju keni lënë familjet tuaja edhe erdhët që të na ndihmoni! Ju jeni shpëtimtarët tonë", dhe në shumë vende edhe shitësit lokal insistonin që të na jepnin gjërat falas, dhe mos t'i pranojnë lekët tanë për sendet që po blenim, e që na thonin; "Ju bëtë dhe po bëni të pa mundurën për popullin tonë, për vëllezërit dhe motrat tona, ne ju kemi shumë borxh juve, ju nuk



17 Qershor 1999 Sojevë /Kosovë, në këtë shtëpi kaluam natën e parë në Kosovën e Lirë me të njëjtën Njësi Speciale Amerikane nga Kukësi në Shqipëri.

duhet të paguani asgjë këtu!" Shpeshherë njerëzit për rreth nesh, edhe na blenin ndonjë pije freskuese, edhe pa i njohur aspakë, por në shenjë faleminderimi!

Ishte një gjest shumë i mire dhe mikëpritës nga popullata lokale dhe refugjatët kosovar, që nuk ka fjalë të përshkruhet. Një gjest që edhe mua më bënte shumë krenar dhe të mburrem para kolegëve të Ushtrisë Amerikane! Kolegët e mijë mbeteshin me gojë hapur, sepse diçka të tillë kurrë nuk kishin patur rast që ta përjetojnë në ndonjë vend të botës ku kishin shërbyer! Ishte diçka e pa zakonit për atë që po përjetonim në qytetin e Kukësit, ngrohtësia dhe mikpritja shqiptare ishte e pa përshkruar. Kolegët e mijë amerikan ishin tepër të mahnitur për këtë popull bujarë dhe kaq të dashur e mikpritës!

Derisa ishim duke bredhë pazarit, Kapiteni Wiggis m'u drejtua mua edhe po më thotë "Ne krejtë ndryshe kemi menduar për shqiptarët këtu, po mendoja se ndoshta do të dyshojnë njerëzit këtu për mos intervenimin tonë direkt të forcave të këmbësorisë mbrenda në teritorin e Kosovës, për t'i shporrë forcat serbe!"

Para nisjes tonë për në Shqipëri, kishim ligjerata speciale për ambientin, ushqimet, popullatën lokale, kulturën dhe religionin e tërë rajonit të Ballkanit.

Kishim edhe porosi strikte nga komanda ushtarake, që mos të marrim apo blejmë asgjë nga popullata lokale, si dhe mos të bredhim shumë jashtë kampeve ushtarake amerikane, për shkak të sigurisë. Po për shkak edhe të helmimeve, por edhe ndonjë sabotazhi nga njerëz të dërguar apo paguar nga pala e armikut serb mbrenda Shqipërisë. Ata na porositën dhe na mësuam se si të kemi kujdes nga kriminaliteti dhe mafia shqiptare. Kemi pasë porosi strikte që as ujë mos të pijmë jashtë në qytet, mos të shfrytëzohet asgjë, përveçse të mirave që janë të siguruar nga Armata Amerikane. Mu për këtë arsye ishim të obliguar që mos të dalim jashta perimetrave ushtarake, po edhe nëse dalim të jemi gjithmonë të mobilizuar në gjendje lufte: me helmetë, xhakëtë anti-plumb, si dhe maskë gazi, dhe gjithmonë të jemi të detyruar që në udhëtime të shkojmë më së paku dy makina ushtarake, për shkak të sigurimit!"

Pas blerjeve që bëmë u kthyem në objektin e vendqëndrimit tonë, dhe me të arritur Kapiteni Wiggis na tha se kishte marrë përgjigjen e Lt. Gjeneralit Hendrix për Gjeneralin Lama!

Për lajmin e Gjeneralit Hendrix, na u desht që menjëherë të nisemi për të shkuar në zyrën e Gjeneralit Lama, dhe për t'ia përcjellë përgjigjen që na kishte dhënë Gjenerali amerikan!

Pritja në zyrën e Gjeneralit shqiptar ishte si çdo here, ku gjerë më tani ishte shumë miqësore nga vetë Gjenerali Lama dhe roja e tij. I sqaruam se tani mundë që të fillojmë me shkëmbimin e mendimeve, materialeve, si dhe të mbledhjes së informatave të ngjarjeve më të reja gjatë ditës.

Nga Gjenerali Hendrix, u porositëm që çdo gjë që bisedohet apo informatave që shkëmbehen

me Gjeneralin Lama duhet të mbeten shumë sekrete, dhe t'i largohemi sa është e mundur takimeve me gazetarë. Gjithëashtu çdo dokument pas punës tonë të shkatërrohet (digjet). Pas kryerjes së bisedës, tani na mbeti edhe një gjë që të na konfirmohet nëpërmjet të telefonit me Shtabin Ushtarak Amerikan në Rinas /Tiranë, se a ishte caktuar që grupi ynë të mbetet si përgjegjës kryesor i ndërlidhjes edhe me dy grupet tjera të atyre:nga Bajram Curri dhe Kruma me grupin tonë në Kukës, dhe Gjeneralit Lama.

Kapiteni Walter J. Wiggis me të cilin isha caktuar unë që të jem përkthyesi i tij personal, ishte i obliguar që të përmbledhë të gjitha të dhënat dhe informatat edhe të grupeve të tjera, e që pastaj ai ishte i obliguar që ato informatat për t'ia drejtuar Gjeneralit Hendrix në Shtabin Qendrorë në Rinas.

Gjenerali Lama na tregoi sot se ishte pakë i prekur për mosmarrëveshjet që kishin ndodhur në lidhje me propozimet e tij dhe të Gjeneralit Hendrix.

Nga biseda që patëm me Gjeneralin shqiptar Lama, shifej se ai më tepër më drejtohej mua direkt, që unë të kem shumë kujdes se si po ia përkthejë informatat në përpikmëri, dhe më kërkoi për çdo gjë të kuptohemi mirë, e në veçanti për terminologjinë ushtarake. Unë i premtova gjeneralit se do të bëjë me përpikshmëri çdo gjë që më drejtohet mua personalisht, edhe pse nga terminologjia ushtarake kuptohet se do të kisha ndonjë mangësi sepse unë nuk kisha ndonjë eksperiencë ushtarake.

Eksperiencën më të madhe në profesionin e një linguisti që kisha unë, ishte me lëndë dhe seancë gjyqësore, punë emigracioni, sigurimet e ndryshme dhe me biseda të lira mjekësore etj, por jo ushtarake. Unë nuk isha ushtar profesional, pasi se as që e kisha kryer ndonjë obligim ushtarak dhe nuk mundë të krahasohesha në terminologji ushtarake siç ishte njësia me të cilën po punoja! Më në fundë që të gjitha palët u ndamë të kënaqura, pas sqarimeve të ndryshme që patëm në mes vete nga ky takim, dhe për takimin e radhës mbeti që të na kontaktojë vetë Gjenerali Lama. Nga zyra e gjeneralit u larguam unë me Kapitenin Wiggis në këmbë, nëpër një rrugicë anësore, një shtegu këmbësorësh pas kazermës ushtarake drejtë për në vendqëndrimin tonë. Rruga na zgjati rreth 10-15 minuta, derisa arritëm në banesën në kazermën e Policisë Ushtarake të Shqipërisë.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Në ditën e sotme pati 425 fluturime të NATO-së prej të cilave u sulmuan caqet duke shkatërruar 6 aeroplanë Galeb në tokë afër Prizrenit, gjithashtu sulmuan edhe pozicionet artilerike të armikut, depon e karburantëve në Beograd, fabrikën e municionit në Valjevë, fabrikën ushtarake në Shabac dhe Vranjë, radio riletet në Loznicë dhe Prepolac.

Në orën 13:15 u bombarduan forcat ushtarake-policore serbe në burgun e Dubravës, në afërsi të Istogut, si dhe qëllohet kazerma



04 Tetor 1999, Sojevë /Kosovë, me Gjeneralet e TMK-së Refki Suma dhe Shaban Shala

ushtarake jugosllave. Në orën 17:30 pas dite, sulmohet kazerma ushtarake në Gjilan, pastaj qëllohet edhe kompania ndërtimore "Binaçka Morava" si dhe kafiteria "Mladost". Bëhet e ditur se sulme pati edhe në fshatin Vujindol në afërsi të Zubin Potokut. Gjithashtu u tha se gjatë ditës së sotme u qëllua edhe kompleksi i mbrojtjes ushtarake në Istog...

Enjte 20 maj 1999

Këtë ditë e filluam më herët se zakonisht. Në orën 9:00 të mëngjesit, Gjenerali Lama na telefoni dhe na ftoi, që menjëherë të nisemi dhe të shkojmë për ta takuar në zyrën e tij unë me Kapitenin Wiggis. Pas ftesës së Gjeneralit, ne të dy me të shpejtë u nisëm në këmbë. U lëshuam të njejtës rrugicë të ngushtë anësore që gjindej aty si rrugë më e shkurtër alternative që deri më tani e kishim kaluar në këmbë unë dhe kapitenin për në kazermën kryesore të Shtabit të Përgjithshëm të Kukësit. Aty gjendej zyra e Komandantit të Divizionit të Këmbësorisë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Gjenerali Kudusi Lama. Nga rruga anësore e shtabit hyrëm mbrenda oborrit të kazermës pa kurrëfarë ndalesë, edhe pse pak më tutje pamë dy ushtarë që po bisedonin në mes vete por nuk na pyetën asgjë! U ngjitëm shkallëve përpjetë për në katin e dytë të godinës, aty ku gjendej zyra e Gjeneralit. Para derës së zyrës, si zakonisht gjetëm rojën personale të Gjeneralit Lama, i cili po qëndronte para derës, dhe me buzëqeshje na përshëndeti dhe na tha që të presim pakë, për derisa ta lajmërojë atë. Roja ishte i njejtë ushtarë që e kishim takuar edhe ditëve të më parëshme që nga fillimi i ardhjes tonë këtu, ishte një djalë i ri ushtarak i moshës rreth 20 vjeç të cilin gjithmonë e gjetëm para derës së hymjes së zyrës. Derisa ne po prisnim, roja trokiti në derën e zyrës së Gjeneralit, pastaj hyri mbrenda dhe e lajmëroi Gjeneralin Lama për arrijten tonë. Nuk vonoi pak, doli Gjenerali në derë, dhe me buzëqeshje na përshëndeti dhe na dëshiroi

mirëseardhje. Edhe sot pritja nga ai na u bë si ditëve të mëparëshme, miqësore dhe me shumë zemërgjërësi. Gjenerali Lama ishte i gëzuar sepse kishte marrë përgjigjen positive prej Gjeneralit Hendrix, që unë me Kapitenin Wiggis të jemi të autorizuar që të kemi të gjitha takimet direkt me të. Gjenerali Kudusi Lama, në realitet ishte personi më i famshëm që ne po takonim nga rangu i Ushtrisë së Shqipërisë. Ishte edhe personi më i njohur në rrethin ushtarak nga Kukësi e gjerë në Tropojë, i cili për shkak të gjendjes së gatishmërisë luftarake kundër agresorit Serb zakonisht punonte në zyrën e tij deri në orët e vona edhe pas orës 16:00. Pastaj pas kësaj kohe shpeshherë gjendej edhe në front, në kufirin shqiptaro-shqiptarë-pra në kufirin Shqipëri-Kosovë. Rreth kufirit ai po shkonte për të kontrolluar lëvizjet e armikut serb, e sidomos pas këtyre dy incidenteve të fundit që kishin ndodhur, kur forcat serbe kishin hyrë dhe sulmuar edhe në mbrendësi të kufirit të Republikës së Shqipërisë. Edhe biseda e sotme ishte në përgjithësi e ngajshme me atë të ditëve të mëparme, bëhej fjalë për planet për shkëmbim informatash që bombardimet e aviacionit të NATO's të jenë sa më të saktë dhe të suksesëshme. Pas gjysëm ore bisede përsëri unë me kapitenin u kthyem në vendqëndrimin tonë, me shpresë që të fillojmë punën sa më parë për të cilën edhe ishim transferuar këtu në Kukës. Pas disa orësh pushimi, përsëri më merr mua në telefon Gjenerali Lama, për të na ftuar neve që të shkojmë së bashku me kapitenin dhe të takohemi në një lokal afër zyrës së tij. Ne si gjithmonë, ishim të gatshëm dhe menjëherë u nisëm dhe shkuam atje. Aty para lokalit pamë duke na pritë Gjenerali me dy kolegët e tij. Njoftimi me kolegët e tij ushtarak, ishte që në rast se ai shkon në teren, që mos të ndërpritet puna jonë, që ne mundë të kontaktoheshim edhe prej ndonjërit nga këta dy personat ushtarak. Ushtarakët që posa i njoftuam kishin të bënin me lëminë e vëzhgim-zbulimit, për çka do të njoftohemi edhe më mirë në ditët vijuese. Takimi ishte i shkurtër, ishte takim sa për tu njoftuar edhe me këta dy

ushtarakët e personelit të Shtabit të Përgjithshëm në kazermën e Kukësit. Pas këtij takimi përsëri u kthyem në vendqëndrimin ku kishim shkuar nga arritja jonë në Kukës. Gjatë rrugës pamë se sot kishte ardhë këtu në qytetin e Kukësit edhe Sekretari i Kombeve të Bashkuara Kofi Anan për të vizituar refugjatët kosovarë. Vizita e tij ishte për të parë gjendjen e refugjatëve prej së afërmi, të cilët ishin me mijëra të shpërndarë në çadra në të dy anët e rrugës. Ishin vendosur në dalje nga qyteti i Kukësit, dhe para se të arrihet në Aeroportin e Kukësit i cili sa po ishte ndërtuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe e që mbanë emrin e Mbretit Sultan Al Nayhan të Emirateve të Bashkuara Arabe. Kjo ishte shumë afër vendbanimit ku ne po qëndronim.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Me përmirësimin e kohës u rritë edhe numri i fluturimeve të aviacionit të NATO-së. Në 24 orët e fundit patëm 446 fluturime. Sulmet vazhduan kundër forcave serbe duke sulmuar: aeroportin në Prishtinë dhe Batajnicë, sulmuan edhe radio riletet në Loznicë, stacionet komunikuese ushtarake në Beograd dhe Stara Pazova, radio stacionet AM në Serboran, Suboticë dhe Kula, kazermat ushtarake në: Gjilan, Beograd dhe Istog, fabrikën e municionit në Bariçsi dhe depot e karburantëve në: Samobor dhe Batajnicë. Sot bombardimet e aviacionit të NATO-së filluan në orën 1:00 pas mesnate, dhe vazhduan deri në orën 2:05 të mëngjesit. Nga këto bombardime kishin pësuar Shërbimet e Sigurisë Shtetërore në Beograd si dhe qëllohet edhe Kazerma Ushtarake në Topçider të Beogradit, rafineria "Jugpetrol" në Çukarica si dhe nga sulmi në Dedinje ku u dëmtua një pjesë e ndërtesës së Ambasadës së Suedisë dhe Zvicrrës. Para mesnatës u qëllua edhe rezervuari i karburantëve në Somobor të Vojvodinës. Zëdhënësi i NATO-së Jamie Shea tha se aeroplanët e NATO-së gjatë mbrëmjes së djeshme sulmuan edhe garnizonin ushtarak në Beograd...

Epreme 21 maj 1999

Me të zgjuar sotë, detyra jonë kryesore ishte që të bëjmë një banjo, tani para se të fillojmë shpërnguljen në lokalitetin tjetër, i cili më tepër i përngjante një burgu ushtarak me dyer të hekurta, të cilin që kurë erdhëm ishin duke na e adaptuar neve për banim.

Para se të bënim lëvizjen, unë me kapitenin Wiggis edhe Dan vozitësi i Humvee's, shkuam që të shohim se ç'kishin punuar në atë objekt, sepse na u tha se do ti lyenin muret dhe do ta pastrojnë tërë objektin para se të shpërnguleshim ne aty. Pasi shkuam atje, pamë se ende nuk ishin kryer të gjitha punët që duhej kryer para lëvizjes tonë në atë vend, kështu që vendosëm që shpërngulja jonë të shtyhej për në ditën e nesërme. Po, me qëllim që t'i jepej edhe më tepër kohë për t'i kryer punët që ende nuk kishin arritë t'i kryenin.

Në orën 14:00 shkuam për ta takuar Gjeneralin Kudusi Lama në zyrën e tij, sepse gjatë kësaj kohe kishim për t'ia dorëzuar edhe disa informacione nga grupi vëzhgues i Njësisë së Forcave Speciale të Armatës Amerikane të vendosur në Krumë. Gjatë bisedës me Gjeneralin u furnizua edhe me shumë informacione të reja dhe të rëndësishme për forcat dhe pozicionet e pjesëtarëve të UÇK-së, që gjatë bombardimeve të aviacionit të NATO-së të mos i shkaktohet ndonjë sulm i gabuar, si edhe për pozicionet e reja të armikut serb. -Gjatë këtij takimi morëm perimetrat e pozicioneve të shtrirjes së pjesëtarëve të UÇK-së, si dhe prej çfarë njësisë përbëheshin. Kapiteni Wiggis ishte shumë i kënaqur me informacionet që morëm, pasi se tani kishte mjaftë informata se ku duhej vepruar më saktësisht me bombardime të Forcave Ajrore të NATO-së.

Biseduam edhe për sulmin e fundit që po zhvillohej mbi forcat e UÇK-së nga armiku serb në malet afër Junikut. Për këtë edhe Gjenerali Lama na njoftoi se forcat e UÇK-së ishin sulmuar gabimisht edhe nga aviacioni i NATO-së, e ku nga radhët e UÇK-së kishin pësuar viktima në disa ushtarë të vrarë dhe të lënduar.

Bashkëpunimi ynë do të jetë i një rëndësie të madhe, sepse siç po shihej nga terreni, ndoshta dikush nga vëzhguesit edhe me qëllim i kishin dhënë koordinatat e gabuara në sulmet e aviacionit të NATO-së, sa për t'i dëmtuar aradhat e UÇK-së. Për këtë edhe Gjenerali Lama ishte shumë i prekur dhe i hidhëruar.

Pas takimit dhe bisedës tonë që zhvilluam, përsëri i kushtova pazarit të qytetit të Kukësit, atje ku blemë edhe disa artikuj ushqimorë që t'i kemi gati për të gatuar diçka në banesën tonë të re. Shkuam, edhe pse e kishim të ndaluar furnizimin me artikuj ushqimorë nga tregu shqiptar.

Në qytet gjithashtu bleva edhe disa gazeta dhe revista shqiptare sa për të pasë diçka për të lexuar gjatë kohës së lirë. Gjatë kthimit për në banesë, jo largë rrugës në të cilën po udhëtonim, rastësisht pamë edhe një furrë buke ku u ndalëm dhe morëm edhe disa bukë taze,

sepse tani gati se dy muaj nuk kishim pasë asnjëherë bukë të zakonshme normale! Pas kthimit në banesë, menjëherë u ballafaquam dhe hasëm në një kundërshtim për artikujt ushqimorë që posa blemë nga kolegu jonë ndihmës mjeku që kishim, i cili na qortoi se nuk guxojmë të marrim kurrëfarë eushqimesh nga qyteti për shkak të sigurisë tonë shëndetësore. Ai po insistonte gjithëqyshë që ky ushqim të hidhet ose t'ia jepnim dikujt nga kolegët tanë që kishim aty, të policisë ushtarake të Shqipërisë që i kishim në hyrjen tjetër po të njejtës godine. Ai insistonte se ky ushqim nuk guxon të konsumohet nga askush prej nesh, duke na thënë se ky është rregulli ushtarak dhe secili prej nesh duhet që ne t'i përmbahemi! Mirëpo duke e lutë unë me kapitenin Wiggis, disi arritëm që ta qetësojmë dhe bindim atë se ushqimi ishte i sigurtë, pastaj ky ushqim edhe do të zihej, gjë që e bënë edhe më të sigurtë për konsumim. Më vonë unë i mora zarzavatet që t'i laja dhe fillova që t'i përgatisë disa prej perimeve me pakë mish lope, me të cilat arrita të bëjë një gjellë shumë të shijshme. Pasi e bëra gati darkën, disa minuta më vonë iu ofrova që të gjithëve që të shërbehen vetë. Gjatë gjithë kohës derisa unë po përgatisja gjellën, ndihmës mjeku ynë po më vështronte me vëmendje shumë të madhe, dhe vetëmse po tundëte kokën! Filluam ngrënie e gjellës me bukën taze që kishim blerë, në fillim ishim vetëmse unë dhe kapiteni. Derisa ne po darkonim, po shihej se edhe kolegët tjerë erdhën dhe morën pjesën e tyre, ndërsa ndihmës mjeku disi po na lakmonte por donte që të mbante rregullin dhe nuk po shërbehej vetë. Dikur më vonë unë e mora një pjatë dhe ia servova edhe atë pakë gjellë që kishte mbetë. Në fillim po na shikonte si të çmendur se si thyem rregullin ushtarak, por pas disa minutash pasi se e provoi kolegu i rregullave si duket edhe atij i pëlqeu gatimi që kisha bërë

unë, me perime, oriz dhe pakë mish lope që blemë më herët. E bëra gjithashtu edhe sa për t'ju treguar atyre eksperiencën time 15 vjeçare në gastronomi, nga puna në restorantet e ndryshme që kisha bërë. Mirëpo, edhe pasi filloi ngrënie, përsëri na kushtëzoi që mos t'i tregojmë askujt për këtë veprim që bëmë!

Pas darkës lexova deri vonë gazetën që bleva gjatë ditës së sotme, si dhe plotësova fjalëkryqet që kishte gazeta, të cilët tani një kohë të gjatë nuk i kisha parë, diçka që gjatë shkollës së mesme dhe në studime e praktikojta shpeshë...

Informacionet e 24 orëshit të fundit

Gjatë ditës së sotme, në orën 17:30 u bombardua stacioni policor (MUP) në qendër të Gjakovës, i cili ishte edhe pjesë ndihmëse e sulmeve mbi popullatën e pa armatosur shqiptare mbrenda Kosovës nga armiku serb. Sipas informatave të NATO-së thuhet se sulmuan ushtrinë jugosllave dhe forcat e policisë MUP-it që po bënin pastrimin etnik në afërsi të burgut në Istog më 21 Maj 1999.

Sipas informatave serbe, thuhet se bombardimi i 21 Majit shkaktoi kaos dhe tollovi në burg, kur disa të burgosur po tentonin të iknin gjatë asaj kohe dhe rojet që po mundoheshin që të mbajnë gjendjen nën kontrollë. Më 22 Maj, sipas dëshmitarëve thuhet se oficerët e burgut udhëruan rreth 1,000 të burgosur që t'i rreshtojnë në oborrin e burgut, dhe pas disa minutash hapen zjarre mbi ta me bomba dhe mitraloz nga pikat e vëzhgimit mbi muret e burgut, prej të cilëve u vranë shumë të burgosur.

E shtunë 22 maj 1999

Edhe sot koha mbajti shumë mirë, ishte kohë e nxehtë dhe me diell. Në mëngjes, në të zgjuar bëmë sendet tona gati për të lëvizur nga kazerma kryesore e ushtrisë

shqiptare në Kukës në Kazermën e Policisë Ushtarake të Kukësit. Kjo ishte rreth dy kilometra më largë prej ku ishim, në afërsi të Aeroportit të Kukësit, dhe shumë afër kampit (çadrave) kryesor të refugjatëve në Kukës.

Dhomat që na u dhanë për banim siç po dukej njëra prej tyre ishte dhoma e mbajtjes së të burgosurve ushtarak, aty ku gjetëm edhe 3 ushtarë shqiptarë të burgosur për shkak ikjes nga radhët e ushtrisë shqiptare. Pas arrijtes tone aty, të burgosurit i nxorrën dhe i transferuan diku tjetër. Vendosëm që dhomën e burgut ta bëjmë dhomë gjumi, kurse para hymja do të ishte oda e ndejës dhe mikëpritjes, aty ku do të kishim televizorin si dhe dhomën tjetër më të vogël do ta shfrytëzonim për zyre të punës së përditëshme.

Pas dy ditësh pune në meremetimin e këtij vendbanimi, tani dukej se deri diku banesa e re po i përmbyste pak a shumë kushtet tona jetësore. Por, papastërtia ishte ende në nivel të dhimbshëm, thuajse aty nuk kishte pasë kurrëfarë pastërtie!

Në dhomën e burgut ushtarak, që tani e bëmë dhomë gjumi për ne, gjeta 3 emra të gdhendur (shkruar) në mure me ndonjë mjet të mprehtë në mbrendi të malterit që kishte, edhe pse ishin ngjyrosur me gëlqere ende shifeshin ato emrat e gdhendur ku shkruhej: XHEVO, MUJO, SEVDO-KUMANOVË dhe 1998. Nuk e dije se kjo dhomë a ishte shfrytëzuar edhe për mbajtjen e të burgosurve pjesëtarë të UÇK-së, ose edhe ndoshta edhe është shfrytëzuar nga personeli i UÇK-së. Ndoshta edhe ata kanë banuar aty para nisjes për në frontet e luftës mbrenda Kosovës...

Më vonë kuptova nga pjesëtarët e Policisë Ushtarake të Shqipërisë që i kishim aty, se dikur më herët ky lokal qenka shrytëzuar edhe si kamp i UÇK-së. Ky vendëbanim i ri që yn ishte rreth 2 km. largë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Shqipërisë në Kukës, i cili gjindej në anën e kundërt të rrugës

kryesore nga qyteti i Kukësit drejt kampit të refugjatëve kosovarë afër aeroportit.

Qëllimi ynë kryesor ishte që të jemi të vendosur sa më afër zyres së Gjeneralit Kudusi Lama, me qëllim që në çfarëdo momenti, të kemi qasje sa më të shpejtë në informatat më të reja në lidhje me levizjet e forcave paramilitare ushtarake policore serbe. Qëllimi ishte që të jemi në gjendje që sa më shpejtë të informojmë qendrën e Lt. Gjeneral John Hendrix në Shtabin e Armatës Amerikane të Rinasit për aktivizimin dhe bombardimin e objektivave serbe nga aviacioni i NATO's!

Detyra e Gjeneralit Lama të Armatës së Shqipërisë, ishte marrja e listës së informatave me koordinatat sa më të sakta dhe më të reja të vendëndodhjes, apo të kahjes së lëvizjes së forcave serbe nga njësia vëzhguese e UÇK-së mbrenda territorit kosovar. Pastaj ato informata duhej që të na dorëzoheshin neve, mua me Kapitenin Wiggis që ishim pothuajse gjithmonë së bashku.

Detyra ime kryesore ishte: nga fillimi pasi të marrim listen, që unë ta përktheja nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe pasataj ti verifikojë emrat e vendeve sa po përputheshin me koordinatat e dhanura në listën e informacionit, dokumentet që na vinin nga njësia vëzhguese e UÇK-së në teren, lista ku shënonin koordinatat me emrin e vendit, numrin e forcave të armikut serb, llojet dhe numrin e automjeteve ushtarake si dhe llojet e armatimit që kishin ata.

Në zyrën tone, në njërin murë kishim të varur hartën e përmasave të madha topografike serbe të Kosovës! Pasi se shumica e emrave nga arena e luftës që na vinin, ishin në gjuhën shqipe dhe mua mu deshtë që në përpikmëri t'i përkthejë. E nëse ndryshonin, duhej edhe t'i verifikojë përputhshmërinë e emrave të vendbanimeve prej shqip në serbisht siç ishin të shënuara në hartën jugosllave të Kosovës. Gjithashtu kërkohet edhe verifikimi i materialeve që na vinin prej grupeve tona të Forcave Speciale për rreth kufirit Shqipëri-Kosovë, në Bajaram Curr dhe Krumë.

Përpunimi i këtij materiali duhej të bëhej sa më shpejtë që na ishte e mundur, e që pastaj Kapiteni Wiggis t'ia transmetonte Lt. Gjeneralit Hendrix në Shtabin e Armatës Amerikane në Rinas të Shqipërisë. Ai duhej që menjëherë t'ia transmetonte Gjeneralit Wesley Clark në Shtabin e NATO-së në Bruksel të Belgjikës, me qëllim të aktivizimit të sulmit nga aviacioni bombardues i tyre mbi caqet e udhëzuara mbi forcat e armikut serb kudo që të ndodheshin ato, për rreth kufirit apo në mbrendi të Kosovës!

Bombardimet e NATO-së ishin kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) në luftën e Kosovës që filluan nga 24 Marsi 1999, dhe vazhduan deri në arrijtes e marrëveshjes e cila detyroi tërheqjen e plotë të forcave të armatosura jugosllave nga Kosova. E këto mbaruan pas 78 ditë bombardimesh deri me nënshkrimin e "Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës, apo "Kapitulimit Serb", më 10



23 Mars 2001 Gjilan /Kosovë, takimi me Komandant "Remin" Rrustem Mustafa në kazerma kryesore e ushtrisë në Gjilan / Kosovë.

qershor 1999. Ky operacion oficial i NATO's gjatë kësaj kohe ishte i koduar me emrin: "Operacioni i Forcave Aleate" (Operation Allied Force) deri në zëvendësimin e forcave jugosllave me Forcat Paqëruajtëse të Kombeve të Bashkuara, por të cilat do të jenë nën komandën e NATO's.

Personazhet kryesore të këtij operacioni ishin: nga Shtabi i Komandës Supreme të Aleancës së NATO's në Bruksel, ishte Gjenerali Wesley Kanne Clark, Sr. Gjenerali Clark u lind më 1944 në Chicago të Illinois, më 1966 diplomohet si nxënës në dalluar në West Point, pastaj vazhdon studimet për Filozofi, Politikë dhe Ekonomi në Universitetin e Oxfordit. Ai më vonë magjistrin në Shkencat Ushtarake.

Gjenerali Clark shërbeu 34 vite në Armatën Amerikane, aty ku mori një numër të madh dekoratash ushtarake si dhe Medalen e Lirisë nga Presidenti Clinton.

Gjenerali Clark është i njohur edhe nga Betejat- Luftërat: Lufta në Vietnam dhe tani lufta e Kosovës dhe pas luftës së Kosovës në vitin 2000, pensionohet nga Armata Amerikane.

Personi tjetër shumë me rëndësi në Operacionin e Forcave Aleate e që ishte i angazhuar nga Shtabi i Armatës Amerikane në Rinas të Shqipërisë është edhe Arbëresho/Amerikani Gjenerali John Walter Hendrix, me të cilin unë dhe njësisia jonë nga Kukësi ishim në lidhje të përditëshme direkte me atë.

Gjenerali Hendrix është i lindur më 1942 nga një familje me prejardhje Arbëreshe. Pasi kreu inxhinjerinë më 1965 më 1978 magjistroi historinë në Middle Tennessee State University si dhe diplomoi në United States Army War College dhe United States Army Command and General Staff College.

Gjenerali Hendrix ishte i njohur nga lufta e Vietnamit, lufta e Gjirit në Lindjen e Mesme dhe lufta e Kosovës.

Gjatë karrierës së tij ushtarake Gjenerali Hendrix ishte fitues edhe i shumë medaleve dhe meritave ushtarake...

Ndërlidhësi ynë kryesor në Operacionin e Forcave Aleate të NATO's ishte edhe Gjenerali Kudusi Lama, Komandanti Divizionit të Këmbësorisë në Kukës.

Gjenerali Kudusi Lama është i lindur më 1951. Shkollën e mesme të agronomisë e kreu në Peshkopi kurse më vonë vazhdon shkollën ushtarake në Kavajë dhe pastaj në studimet e Akademisë Ushtarake në Tiranë dhe më 1966 doktoron në Shkencat Ushtarake. Gjenerali Lama njihet për punën e tij të palodhëshme edhe në Luftën e Kosovës, për çka edhe ne jemi dëshmitarë dhe shumë mirënjohës për ndihmën dhe strehimin që na ofroi mua me Njësinë e Forcave Speciale të Armatës Amerikane gjatë qëndrimit tonë në Kazermën Ushtarake të Kukësit.

Gjatë karrierës së tij ushtarake Gjenerali Lama është dekoruar edhe me shumë medalje dhe mirënjohje të ndryshme...

Dhe nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK'së Lt. Gjenerali Agim Çeku me Njësinë vëzhguese të UÇK'së prej

mbrenda Kosovës.

Lt. Gjenerali Agim Çeku u lind më 1960 në Pejë.

Shkollën e mesme e filloi në Beograd dhe e kreu në Zarë të Kroacisë prej nga iu bashkangjit Armatës Popullore Jugosllave. Gjatë luftës në Jugosllavi kalon në forcat ushtarake Kroate ku më vonë i besohet edhe komanda e divizionit ushtarak. Më 1995 me forcat Kroate ai merr pjesë edhe në planin e "Operacionit Stuhia" e cila i dha fund luftës në Kroaci. Ai u dekorua shumë herë duke marrë gradën nga Presidenti Kroat Franjo Tuxhman. Më 1999 dorëhiqet nga posti i ushtrisë kroate dhe i bashkangjitet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), e që më vonë filluam që ne të informohemi edhe më saktë për lëvizjet dhe pozicionet e forcave serbe, prej nga edhe sulmet e aviacionit të NATO-së u bënë edhe shumë më të sakta në arritjen e qëllimeve tona...

Edhe Lt. Gjeneral Çeku u dekorua shumë herë nga shteti i Kroacisë dhe ai i Kosovës për meritat e tij gjatë luftës në Kroaci dhe në Kosovë...

Gjatë takimit të sotëm me Gjeneralin Lama, ai na njoftoi se para dy ditësh në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në Kosovë, ishte paraqitë një oficer kinse nga forcat e NATO-së me emrin Daniel. Ky person kishte shku atje me qëllim që të kishte bashkëpunim direkt me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në Kosovë! Për këtë person njësisia jonë nuk kishim kurrëfarë njoftimi, dhe disi mbetëm të habitur nga ky lajm! Kjo informatë i kishte ardhur Gjeneralit Lama drejtëpërdrejtë nga Lt. Gjenerali i UÇK-së Agim Çeku, i cili e kishte mirëpritur atë farë oficeri ushtarak!

Lt. Gjeneral Çeku i kishte shprehë atij dëshirën e bashkëpunimit me të, mirëpo me kusht që poqëse dëshironte ai që të bashkëpunojë me të. Pikë së pari ai duhej që të shkojë dhe të paraqitet në Shtabin e Përgjithshëm Amerikan në Rinas te Gjenerali Hendrix, dhe pastaj që Gjenerali Hendrix ta e dërgojë atë direkt te Lt. Gjeneral Çeku!

Nga biseda që patëm, diçka nuk ishte në rregull, pasi se deri më sot ai farë oficeri ende nuk ishte paraqitë në Shtabin Amerikan në Rinas. Kjo ishte diçka e pa zakonit, por do mbetet të shihet në ditët e ardhëshme.

Gjithashtu me të biseduam edhe për pozicionet për rreth kufirit Shqipëri-Kosovë të Armatës së Shqipërisë si dhe për pozicionet e forcave të UÇK'së. Për palën amerikane dhe NATO'n në përgjithësi ishte ndihma e pa mohueshme e njësisë vëzhguese të forcave të UÇK'së që po na informonte për pozicionet e forcave kriminale paramilitare ushtarake policore serbe.

Tani kur ishim gati të nisemi nga zyra e Gjeneral Lama për zyrën tonë, në të njejtën kohë caktuam edhe takimin e radhës për në ditën e nesërme, dhe u caktua që përsëri të jemi në zyrën e Gjeneralit në orën 9:00 të mëngjesit. Deri sa ne ende ishim në zyrën e tij, atijë veçse i erdhi dikush në oborr poshtë zyrës, ishin nga personeli i Ambasadës Amerikane në Tiranë



04 Qershor 2001 Kaçanik /Kosovë, gjatë vizitës së së vajzave Liridona dhe Mimoza Emini

me disa pjesëtarë të CIA'së. Për derisa ne po tentonim që të largohemi nga zyrja, ata veçse na zunë hymjen dhe u ngjiten shkallëve përpjetë për në zyrën e Gjeneralit Lama! Me të shpejtë gjenerali u detyrua që të na fusë neve në dhomën tjetër përballë zyrës së tij, dhe për derisa ato hynë mbrenda zyrës së tij, ne me të shpejtë dolëm nga dhoma tjetër edhe ikëm pa u parë apo takuar me asnjërin prej tyre. Pastaj vazhduam rrugën tonë të rregullt, atje drejtë shtegut përpjetë për në zyrën tonë!

Sa për sqarim, njësisia jonë e Forcave Speciale të Armatës Amerikane, e kishim të ndaluar rreptësisht që mos të takohemi, apo edhe që mos të kemi kurrëfarë kontakti me këdo qoftë prej jashta shtabit tonë të Armatës Amerikane dhe të ndërmjetësuesit ndërlidhës Gjeneralit Kudusi Lama, pa marrë parasysh se kush është, po të ishin edhe ata të Ambasadës Amerikane apo edhe të CIA-së Amerikane, apo edhe çfarëdo gazetari qoftë!

Rrugën për në vendbanimin dhe zyrën tonë e bënim çdo herë në këmbë, ishte një shteg këmbësorësh apo një rrugë anësore me një përpjetëze rreth dy kilometrash larg prej zyrës së Gjeneralit Lama.

Me të arritur në zyrën tonë menjëherë iu përkushtova punës time të rregullt, duke bërë përkthimin e listës së re të informacioneve të ardhura nga Gjenerali prej njësisë vëzhguese të UÇK-së, si dhe verifikimin e të gjitha pikave strategjike që i morëm prej Gjeneralit Lama. I përcaktuam se cilat pika ishin më esenciale dhe ku duhej sulmuar forcat e aviacionit të NATO-së mbi trupat e kriminelëve paramilitare ushtarake policore serbe, të cilat pastaj Kapiteni Wiggis me kolegët e tij ia përcollën Gjeneralit Hendrix në Shtabin e Armatës Amerikane në Rinas të Shqipërisë. Do të vazhdonim më tej te Gjenerali Clark në komandën supreme në Bruksel për të orkestru me bombardimet e aviacionit të NATO's mbi forcat serbe kudo qofshin...

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë 24 orëve të fundit patëm 684 fluturime të forcave aleate të NATO's.

Në Kosovë u qëlluan 12 tanke, 11 autoblanda, 9 pozicione të artilerisë edhe 7 automjete të ushtrisë serbe. U sulmuar edhe kazermat si dhe vendëndodhjet e armatës dhe forcave të MUP'it të cilat po mirreshin me pastrime teknike në afërsi të burgut në Istog, si dhe satacionin ndihmës të MUP'it në Gjakovë. Sot u sulmuar edhe pikat kufitare në Glava dhe Vokagjan. U sulmuar edhe largëpërçuesit e rrymës në: Beograd, Veliki Cerljeni, Bajina, Nish, Dermo si dhe largëpërçuesi për fabrikën e bakrit në Bor dhe rafineria në Smederevë.

Sulme pati edhe në objektet që ndihmojnë forcat serbe në Kosovë, si depot e municionit në: Sremski Karlovci, Sremska, Kraljevë, Pozhegë si dhe urat në: Veliko Orasje dhe Banatski Dvor. U sulmuar kazemat e armatës serbe në: Piroto dhe Prizren. Gjithashtu u qëlluan edhe qendra e komandës dhe kontrollit të lidërshiptit të Presidentit Milloshëviq ne Dobanovci dhe në vazhdim u sulmuar edhe riletë e transmuetesit të radios dhe TV në: Kaçanik, Palist, Novi Sad, Mladenovac dhe Prepolac. U sulmuar edhe depot e karburanteve në Prahovo dhe Smederevë...

E diel 23 maj 1999

Si zakonisht edhe sot u zgjuam rreth orës 7:00 të mëngjesit, dhe rreth orës 9:00 të mërritëm në zyrën e Gjeneralit Kudusi Lama. Pikë së pari duhej sqaruar edhe rastin e atij farë oficerit të NATO-së të quajtur Daniel, i cili paska shku për t'u inkuadruar në ndihmë direkte të Lt. Gjenerali Agim Çekut të UÇK-së. Sipas informacioneve të Shtabit të Përgjithshëm Amerikan në Rinas, i ashtuquajtur oficeri Daniel i NATO-së që ishte paraqitë në Shtabin e UÇK-së nuk na ishte paraqitë dhe nuk paska

kurrëfarë lidhesh me gjeneralin Amerikan Hendrix!

Në të mbërrirë para zyrës së Gjeneralit Lama, roja e tij na njoftoi se tani për momentin ai na qenka i nxanun, mirëpo kishte kërkuar që të takohemi më vonë, i cili na propozoi që ne përsëri të ktheheshim te ai, sot pas dite në orën 16:00, që të takohemi me të dhe të furnizohemi me listën më të re të objektivave të armikut serb. Po, për t'i bërë gati për bombardimet e ardhëshme të aviacionit të NATO-së, si dhe të na informojë edhe më saktësisht për pozicionet më të reja të forcave të UÇK-së si dhe të Ushtrisë së Shqipërisë për rreth kufirit Shqipëri-Kosovë. Kjo bëhej me qëllim që mos të bëhet ndonjë gabim nga aviacionet e NATO-së, siç kishte ndodhur në disa raste më pare. Kjo ishte edhe kërkesa kryesore e Gjeneralit Hendrix si dhe e Kapitenit Wiggis!

Pas arritjes te zyreja e Gjeneralit Lama kuptuam se ai kishte qenë në mbarim e sipër të ngrënies së drekës së tij. Në të arritur lartë në katin e dytë menjëherë Gjenerali doli para derës edhe na priti me fjalën popullore, duke na thënë: "Vjerra nuk po ju dojka", që don të thotë se nuk e arritëm me kohë drekën që të kishim ngrënë edhe ne!

Me të hyrë mbrenda zyrës, Gjeneral Lama menjëherë nxorri hartat topografike që i kishte, dhe filloi për të na i tregu se ku ndodheshin pozicionet e Ushtrisë Shqiptare, si dhe ato të forcave të Ushtrisë së UÇK-së, per rreth kufirit Shqipëri-Kosovë. Tani pa kurrëfarë sekretit, sepse dihej se qëllimi ynë kryesor ishte ndihma sa më efikase për forcat e UÇK-së. Për derisa kopjuam të gjitha pozicionet ushtarake nga hartat e Gjeneralit Kudusi Lama në hartën personale të Kapitenit Wiggis, na mori më tepër se dy orë punë.

-Pas përfundimit të punës së hartave, Gjenerali Lama na pyeti se a dojmë të takohemi edhe me njërin nga udhëheqësit e UÇK-së në Kosovë, zotëriun i cili kishte në plan për ta vizituar Gjeneralin gjatë këtyre 2-3 ditëve në vijim?

Po i thamë, mundë që ta takojmë. Por me kusht që nëse e bëjmë takimin, patjetër se duhet bërë në prezencën tuaj. Kështu, sepse të këtuilla i kemi urdhërat dhe udhëzimet nga Gjenerali Hendrix dhe komanda e NATO's, që të gjitha takimet me pjesëtarë të UÇK-së mundë të bëhen vetëm në prezencën e palës së Ushtisë së Shqipërisë. Donë të thotë me ndërmjetësimin e Gjeneralit Kudusi Lama, apo edhe ndonjë personaliteti me rëndësi për shkak të marrëveshjes OKB-NATO.

Pas pakë kohësh, pasi e kryem detyrën tonë, Gjenerali Lama na ofroi nga një dollë whisky "Ballantines", të cilin po sa ia kishte sjellë një Atashe Anglez, një orë më herët! Me të na solli edhe disa specia të freskët djegës dhe një domate turshi me xhizë, të cilat i kishte shumë për qejfi, e të cilat i morrëm me vete që t'i kemi për më vonë gjatë darkës së kësaj mbrëmje.

Një lajm të veçantë që morëm aty ishte, se morëm vesh edhe për lirin nga forcat serbe e mëse 500 refugjatëve meshkuj shqiptarë që ishin kidnapuar dhe të cilët ishin tepër të maltretuar dhe torturuar nga forcat kriminale paramilitare ushtarake policore serbe. Gjatë bisedës për gatime që po bënim, Gjenerali Lama na premtoi se së shpejti do të na vijë në darkë për të provu edhe specialitet tona, sepse ai ishte edhe kureshtarë që të na shohë se me çfarë ushqimi po ushqeheshim ne!

Gjenerali Lama sot na kishte sjellë edhe një televizor për ta shfrytëzuar e për të parë ndonjë lajm, dhe sa për t'u njoftuar me risitë në botë, si dhe për të hequr monotoninë tonë në vendbanimin që na kishte siguruar ai. Qëllimi ynë kryesorë ishte që të kryenim detyrat në mënyrën sa më korrekte që të jetë e mundur, sepse i kemi shumë borxh të rinjëve që iu kyçën aradhave të UÇK-së. Takimin që zhvilluam me Gjeneralin ishte i mirë dhe shumë i vlefshëm për punën tonë të mëtutjeshme...

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë ditës së sotme nga aviacioni i NATO's pati sulme edhe mbi trupat dhe kazernat ushtarake në Kosovë. Aviacioni i NATO's qëlloi më së paku: 9 autobllinda, 10 pozicione artilerie, tanke dhe automjete ushtarake, 3 aeroplanë luftarak, 2 automjete lancues raketash tokë-ajër SA-6 si dhe radarë. Në Kosovë u qëlluan edhe objektet ndihmëse të forcave serbe si: Posti komandues në Rakovicë, depoja e municionit në Ferizaj, Mitrovicë të Kosovës dhe Mitrovicë të Sremit, depoja e karburantëve në Smederevë dhe Leskovc, transmetuesit e radios dhe TV në: Kula, Kaçanik, Bodeva dhe Prepolac si dhe depoja e MUP'it në Beograd dhe oborri i trafës elektrike në Obrenovac.

E hënë 24 maj 1999

Edhe sot po mbanë një ditë e bukur, jo nuk jemi shumë të nxanun me detyrat që kishim. Gjatë ditës së sotme patëm disa informata për lëvizje të reja dhe pozicionet e armikut serb, të cilat

pas përkthimit dhe verifikimit të koordinatave të tyre, ia përcollëm Shtabit të Forcave Aleate Amerikane në Rinas-Tiranë, e që pastaj ata t'ia përcillin Shtabit të NATO-së në Bruksel, prej nga Gjenerali Wesley Clark si Komandant Suprem do t'i urdhërojë bombardimet e avacionit të NATO-së mbi objektivat e dhëna.

Për darkë sonte, unë me njërin nga kolegët e mi ushtarak po përgadisnim mish viçi me oriz dhe zarzavate perimesh që i blemë më herët. Një darkë e cila na u bë mjaftë e shijshme, ku para se të darkonim vendosëm që të ftojme në darkë tani edhe kolegun tonë Gjeneralin Kudusi Lamën me të birin e tij i cili i kishte ardhë për vizitë këtu në Kukës. Djali i Gjeneral Lamës, me profesion ishte mjek i përgjithshëm ushtarak.

Para përfundimit të përgaditjes, i telefonova Gjeneralit për t'i bërë ftesën për në darkë me të cilin tani përveçse punës që kishim së bashku, me të kishim krijuar edhe një miqësi të shëndoshë dhe shumë të mirë. Me të ftuar Gjeneralin, ai përmenjëherë e pranoi ftesën tonë, ndoshta e kishte edhe më tepër nga kurioziteti që të shohë se si ushqehemi ne!

Nuk vonoi shumë, pas 20 minutash arritën tek ne babë e birë. Pas ardhjes së tyre në darkë, pa kurrëfarë vonese i servuam secilit nga një pjatë gjelle që sapo gatuam dhe me nga një copë bukë të freskët Kukësi të cilën po e pëlqenim pa masë. Darka që servuam sa më duket i pëlqeu që të gjithëve, dhe me të vërtetë gatimi që bëmë u bë mirë edhe kishte shije shumë të mire. Kjo u vërtetua sepse gati të gjithë që u ushqyem, të gjithë i pastruan pjatat. Pra, nuk lamë asgjë e gati se nuk pati nevojë as që t'i lajmë ato! Pas darke vazhduam me bisedë rreth punës, planeve edhe për jetën tonë personale.

Ishte bisedë e ngrohtë dhe mjaftë vëllazërore, e që e vazhduam deri vonë në mbrëmje. Gjeneralit iu duk pak si interesante dhe me ambientin se si i kishim arritë që ta përshtatim ashtu në atë mënyrë. U mahnit me të gjithë ato ndërrime që i kishim bërë, duke e shndërruar atë nga burgu ushtarak në një banesë të transformuar mjaftë mirë, komode dhe me shije të mirë për jetën ushtarake! Më vonë gjatë mbrëmjes patëm edhe vizitorë nga Baza Ushtarake Amerikane e Rinasit. Ishin një grup ushtarësh amerikan, të cilët kishin ardhë për të na furnizuar me ushqimet tona ushtarake MRI, si dhe gjërat tjera të domosdoshme që na duheshin këtu në Kukës. Ata gjithashtu na kishin sjellë edhe veshmbathjen tonë që i kishim lënë prapa për t'i pastruar.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Edhe pse sot mbajtë kohë e keqe, bombarduesit e NATO's shkatërruan: 7 autobllinda, 12 pozicione të mortajave, 9 pozicione të artilerisë si dhe disa automjete ushtarake serbe, si dhe radar, qendra komanduese dhe një tank.

Për shkak të kohës së keqe që ishte pati vetëmse 554 fluturime, por sulmet vazhduan gjithandë Kosovës dhe Jugosllavisë si në: Shtabet e Policisë Speciale të MUP'it në Ferizaj dhe Prizren, depot e municionit në Gjilan, Mitrovicën e Sremit dhe Ferizaj, trafat e energjisë elektrike në Nish, Dermno dhe Novi Sad. Në vazhdim aviacioni i NATO's qëlloi edhe rrejtjet e radios në Prishtinë, rrejtjet e stacioneve TV në Kaçanik, aeroportin në Ponikve dhe depon e karburantëve në Somobor. Raportohet se në orën 13:35 u sulmuam kazernat ushtarake në qendër të Shabacit, diku në mes të Serbisë.

E martë 25 maj 1999

Lirisht mundë të them se kjo ditë e sotme ishte ndër ditët më dinamike për mua, që nga dita e parë e fillimit kur nisa të punoj me Armatën e SHBA'së e deri më sot, që kur erdha në shtetin amë të Shqipërisë. Gjatë mëngjesit menjëherë pasi se u zgjuam nga gjumi, caktuam takimet me bashkëpunorin tonë Gjeneralin Kudusi Lama. Në orën 8:30 të mëngjesit veçse arritëm në zyrën e tij për të marrë listën e informatave më të reja të njësisë së vëzhgimit të UÇK- së, për caqet më të reja. Objektivat më të rinjë do të na shërbenin për vazhdimin me sulmin e bombardimeve mbi caqet e armikut kriminel, paramilitaro ushtarako policor serb.

Në orën 9:30 të mëngjesit, pasi morëm listën e re u kthyem në zyrën tonë të punës, ku menjëherë unë vazhdova me përkthimin dhe verifikimin e këtyre pikave të reja, e që pas përfundimit të detyrës sime ia dorëzova Kapitenit Wiggis, i cili me kolegët e tij i përpunoi edhe ia transmetoi zyrës së Gjeneralit

Amerikan Hendrix në Rinas. Pastaj Gjenerali Hendrix do t'ia përcjellë zyrës së Komandantit Suprem të NATO's në Bruksel Gjeneralit Wesley Clark, e që pastaj ai të japë dritën jeshile në urdhërin për sulmet e ardhëshme të bombardimeve nga aviacioni i NATO- së mbi forcat serbe gjithë andej në teren.

Derisa ne ende po punonim në caqet që kishim, pak më vonë në lajmëruan nëpërmjet radiolidhjeve ushtarake nga Shtabi i Përgjithshëm Uashtarak në Rinas - Tiranë, se në orën 12:00 në mesditë do të na vijë për vizitë Gjenerali Hendrix me Kolonelin Hannes. Qëllim i tyre ishte të na takojnë neve, po edhe për të takuar Gjeneralin Kudusi Lama Komandantin e Divizionit të Kukësit, e tani edhe ndërldhësin kryesorë tonin me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe të Lt. Gjeneralit Agim Çeku të UÇK-së.

Sa për sqarim, mbi 90% të akcionit të sulmeve të avacionit Amerikan që u shrytëzuan për bombardime mbi forcat e armikut gjakatarë serb, ishte direkt rezultat i punës së bashkëpunimit tonë, në mes të: Neve të Njësisë së Forcave Speciale Amerikane me Gjeneralin Hendrix dhe Gjeneralit Kudusi Lama si dhe Lt. Gjeneralit Agim Çekut!

Nga të gjitha sulmet e NATO-së në Operacionin e Forcave Aleate, 61% e këtyre sulmeve u ekzekutuan nga aviacioni Amerikan, dhe shumica e këtyre sulmeve ishin nën direktivat tona të Njësisë së Forcave Speciale Amerikane në bashkëpunim me Gjeneralin Kudusi Lama të Armatës së Shqipërisë si dhe Njësisë Vëzhguese të UÇK-së prej këtu nga zyrat tona në Kukës!

Me të marrë lajmin për ardhjen e më vonshëm të Gjeneralit Hendrix me Kolonelin Hannes gjatë ditës së sotme, menjëherë e lajmërova


edhe Gjeneralin Lama se sot do të kemi në vizitë Komandën e Shtabit Ushtarak Amerikan nga Rinasit, të cilët edhe shprehën dëshirën dhe po donin që të takohen edhe me ju!

Gjenerali Lama pa kurrëfarë hezitimi menjëherë shprehu mirëseardhjen dhe gëzimin për ardhjen e tyre, si dhe më pyeti se a mundë që të vijë edhe ai vetë personalisht për t'i pritur mysafirët së bashku me ne para se të arrijn këtu te ne në Kukës në vendë qëndrimin (banesa) tonë! "Po" i thashë, "Pse jo? Me plotë dëshirë dhe gjithmonë edhe në çfarëdo kohe na je i mirëseardhur si në shtëpinë tënde (edhe ashtu kjo ishte pronë ushtarake e Republikës së Shqipërisë, d.m.th. pronë e tij). Bile mikëpritja e jonë së bashku me ju zotëri, do ta bëjë edhe më madhështore pritjen, për shkak se ata edhe pse po vinin që të na vizitonin neve, qëllimi kryesorë i tyre ishte edhe që të takohen edhe me ju!". Ata po vinin te ne edhe për shkak se ne ishim edhe forca mbrojtëse dhe e sigurisë për to. Por, edhe për të gjithë liderët ushtarak amerikan apo kushdo qoftë nga pjesëtarët e NATO-së, po që do të vinin në këtë rajon!

Para banesës dhe zyrës tonë kishim një hapësirë të madhe, tokë të pa punuar si dhe oborr të gjatë dhe të gjërë, e që lirisht mundë të shfrytëzohej edhe për aterimin e helikopterëve ushtarak!

Në orën 12:05 të drekës, derisa ne po pritnim të gjithë së bashku, edhe po bisedonim me Gjeneralin Lama i cili veçse kishte arritur këtu. Larg në qiell të hapur veçse pamë dy helikopterë ushtarak që po na afroreshin për çdo sekondë. Mbrenda një kohe shumë të shkurtër që të dy helikopterët njëri pas tjetrit filluan që të lëshohen në livadhin 20-30 metra para nesh.

Vijon



10 Maj 2000 Sojevë /Kosovë, tani në punë së bashku me Shahadijen në Njësinë e Jurispodencës së Armatës Amerikane "JAG" në kampin "Bondsteel".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Klubet e futbollit: Nëse nuk përfundon licencimi s'do t'i vazhdojmë garat

PRISHTINË, 29 MARS - Në shtëpinë e Federatës së Futbollit të Kosovës të mërkurën është mbajtur takimi i 20 klubeve të futbollit. Aty është diskutuar vonesa e licencimit të

klubeve nga Ministria e Sportit në Kosovë. Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, foli për "Kanal10" në lidhje me këtë takim dhe tregoi se çfarë vendimi morën kryesorët e klubeve, në

veçanti ato të Superligës së Kosovës. "Në rast se nuk përfundon procesi i licencimit deri më 31 mars, atëherë klubet janë dakorduar që të mos vazhdojnë garat", ka thënë

Batina. Ky moslicencim po ndikon dukshëm në buxhetin e klubeve të Kosovës dhe rrezikojnë shumë që të futen në borxhe të mëdha para përfundimit të këtij sezoni.



Ministria e Sportit, Ministria e Mbrojtjes dhe Federata e Xhudos nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

Pejë, 29 mars - Ministria e Sportit, Ministria e Mbrojtjes dhe Federata e Xhudos e Kosovës kanë nënshkruar të mërkurën memorandum bashkëpunimi i cili do të nisë së zbatuari këtë vit. Të pranishëm në nënshkrimin e këtij memorandumit ishin ministri Hajrulla Çeku, ministri Armend Mehaj dhe kryetari i FXHK-së, Agron Kuka. Ministri Mehaj ka bërë me dije se po i jepet jetë konceptit të integritetit të arteve marciale në programet e përhershme trajnuese dhe arsimore në Forcën e Sigurisë së Kosovës. "Po i japim jetë konceptit të integritetit të arteve marciale në programet e përhershme trajnuese dhe arsimore në

koncept, që është në linjë me programin 'Kosova, shtet i xhudos', do të fillojë së zbatuari gjatë këtij viti si pjesë e trajnimeve formale të nivelit bazik, ndërsa ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të FSK-së ashtu që në kuadër të investimit në arsimimin dhe trajnimin e ushtarëve në fushën operacionale, përmes angazhimit të xhudistëve tashmë të mirënjohur ndërkombëtarisht, t'i aftësojmë ushtarakët tanë edhe në aplikimin e arteve marciale si metodë për vetëmbrojtje, neutralizim të kundërshtarit, por dhe nxitje të shpirtit garues ndërmjet ushtarëve, pasi programi është ambicioz, me synimin që Forca e Sigurisë së



Kosovës të marrë pjesë në garat botërore multidisiplinare të Këshillit Ndërkombëtar të Sporteve Ushtarake", ka thënë

Mehaj. "Përmes këtij programi, përveç investimit në përgatitjen e oficerëve dhe ushtarëve, ne po vlerësojmë

edhe profesionalizmin e xhudistëve tanë duke i angazhuar në institucionet tona të sigurisë", ka shtuar Mehaj.



Rama i paraqet tri kampionet olimpike të Kosovës si simbole në Ushtrinë e Shqipërisë

Tiranë, 29 mars - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka shpërndarë në rrjetet sociale një fotografi me tri xhudistet e arta të Kosovës, Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi, duke i cilësuar simbole të reja të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Kosova njihet si vend i xhudos, pasi deri tani ka nxjerrë shumë kampionë, ndër ta kampion Evrope, bote edhe olimpikë. Kelmendi, Gjakova dhe Krasniqi janë tri nga xhudistet më të mira që kanë fituar çdo

medalje të mundshme. Mundi i tyre dhe sukseset nuk kanë mbetur pa u vlerësuar edhe brenda trojeve shqiptare. Kryeministri shqiptar, Edi Rama, ka konfirmuar se tri xhudistet nga Kosova do të jenë simbole të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. "Me tri kampionet olimpikë shqiptare, Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi, vajzat e mahnitshme të Kosovës dhe simbolet e reja të Forcave të Armatosura të Shqipërisë", ka shkruar Rama.

Edhe Sassuolo në garë për Krasniqin

PRISHTINË, 29 MARS - Ish-futbollisti i Ballkanit, Ermal Krasniqi, është bërë objektivi i klubeve evropiane pas paraqitjeve brilante me skuadrën nga Suhareka,

Ballkanin, në pjesën e parë të sezonit dhe më pas me CFR Cluj në muajt e fundit. "Tuttosport" raporton se në garë për 24-vjeçarin është futur edhe Sassuolo.

Klubi nga Seria A është i vetëdijshëm se do të ketë konkurrencë të fortë për përfaqësuesin e Kosovës i cili nuk u ftua për ndeshjet e marsit, por do të tentojë ta bëjë

të vetin lojtarin. Interesim për ish-yllin e Ballkanit kanë shfaqur Fiorentina, Lazio, Udinese, Torino e Mallorca, kurse vlera e tij sillet rreth 15 milionë euro.



Arteta: Saka është lojtari kyç i Arsenalit këtë sezon, po na jep titullin

LONDËR, 29 MARS - Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, ka vlerësuar cilësitë e mesfushorit Bukayo Saka si të jashtëzakonshme, duke e konsideruar 21-vjeçarin vendimtar këtë sezon. Në Premierë Ligë ai ka realizuar

12 gola e 10 asistime në 28 ndeshje, duke qenë i pazëvendësueshëm për Artetan. "Ai është shumë konstant në lojën e tij dhe kjo është e rëndësishme, sidomos duke parë moshën e tij të re. Një gjë e tillë është e rrallë për

moshën e tij dhe ai e konsideron këtë gjë shumë normale. Për mua ai ka mundësi të përmirësohet edhe më shumë", u shpreh Arteta. "Unë jam shumë i lumtur që e kam në skuadër, pasi pres që ai të përmirësohet edhe më

shumë. I ka kapacitetet për ta bërë këtë gjë. Jam i sigurt se ai ende nuk ka dhënë 100 % të aftësive të veta të cilat do t'i shohim me kalimin e viteve, kur do të bëhet edhe më i pjekur në fushë", ka deklaruar Arteta.



Alonso: Njerëzit mendonin se isha në një tunel të errët, por jam kampion

Londër, 29 mars - Dy garat e para të këtij sezoni në Formula 1 (Bahrein dhe Arabi Saudite) provuan se Aston Martin është një nga makinat që mund të surprizojë shumë. Skuadra britanike, e udhëhequr nga një pilot ekspert si Fernando Alonso, ia ka dalë t'i "bezdisë" edhe kampionët e Red Bullit me pilotin Max Verstappen për të mos përmendur që duken më mirë se Mercedesi e në disa raste edhe më mirë se Ferrari. Në dy garat e para Fernando Alonso është ngjitur dy herë në podium, diçka që nuk ndodhte prej vitit 2007 kur mbronte titullin kampion me McLarenin. Falë dy podiumeve, Alonso ka grumbulluar deri më tani 30 pikë, një shifër që nuk e prekte prej 2012-s. Por, nëse të gjithë flasin për rikthimin e spanjollit, vetë piloti veteran thekson se ai ka besuar gjithnjë te vetja pasi, siç edhe e thekson, ai është kampion bote. "Njerëzit



mendonin se isha në një tunel të errët nga i cili nuk do të dilja kurrë, por jam kampion bote. Kam fituar në vitet e fundit jo vetëm në Formula 1. Bota e motorsportit nuk është vetëm Formula 1. Tani jam rikthyer mes pretendentëve me Aston

Martinin, por nuk më duket sikur më është rikthyer jeta. Duhet të kuptojmë se nuk ndryshon shumë vendi i tretë me të shtatin, të paktën për mua personalisht, sepse unë mendoj se në garë fiton ose humbet, nuk ka rrugë tjetër", u shpreh 41-vjeçari.

Bostoni zhgënjen dhe i largohet kreut, Golden State 'fluturon' me Curryn

UASHINGTON, 29 MARS - Humbje e thellë për Bostonin, që u mund me rezultat 130-111 nga Washingtoni, duke ndërlikuar sfidën për kreun në Konferencën e Lindjes. Porzingis realizoi 32 pikë e 13 rebounde për Washingtonin. Fitore në sekondat e fundit për Atlantan, që mundi me rezultat 120-118 Clevelandin, ndeshje ku u dallua Murray me 29 pikë, ndërsa 44 pikët e Mitchellit mbetën për statistikë. Fiton edhe



Toronto, që mundi me shifrat 106-92 Miamin, ndeshje ku Siakam realizoi 26 pikë, mbështetur edhe nga Anunoby e Barnes, me nga 22 pikë secili. Kampionët e Golden States

mundën me rezultat 120-109 New Orleansin, me Stephen Curryn protagonist, autor i 39 pikëve. Ndërsa Memphis, falë 31 pikëve të Banes, mundi Orlandon 113-108.

REZULTAT

Washington - Boston	130-111
Atlanta - Cleveland	120-118
Toronto - Miami	106-92
Memphis - Orlando	113-108
Oklahoma - Charlotte	134-137
Golden State - New Orleans	120-109

SHKURT

Khaka i kënaqur me dy fitoret e Zvicrës

Zvicra e ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme ciklin e kualifikimeve për Kampionatin Evropian të vitit 2024. "Helvetikët" në dy ndeshjet e para kanë fituar, ndërsa nuk kanë pësuar asnjë gol. Zvicra fillimisht e mposhti Bjellorusinë me rezultat 5-0 e më pas edhe Izraelin me 3-0. I kënaqur me këto rezultate është shprehur edhe kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka. "Patëm një paraqitje dominuese, sidomos në pjesën e dytë. Gjashtë pikë nga dy ndeshje, asnjë gol i pësuar. Kjo është gjithçka që mund të bënim. Nuk është gjithmonë e lehtë kur je favorit në grup, por ne jemi gati për sfida", ka thënë Xhaka.

Zvicra gjendet në Grupin I bashkë me Kosovën, Rumaninë, Izraelin, Bjellorusinë dhe Andorrën.

Enkileda Carja, e bronzë në botërorin e peshëngritjes

Peshëngritësja shqiptare Enkileda Carja ka fituar medaljen e bronzë në kampionatin botëror për të rinj në peshëngritje, ngjarje që po zhvillohet në qytetin e Durrësit. Ajo u plasua e treta në peshën 59 kg, duke i dhënë Shqipërisë dy medalje, në stilin e shkëputjes dhe në dy gara. Sipas IWF (Federata Ndërkombëtare e Peshëngritjes), Carja është peshëngritësja e vetme deri më tani që ka marrë medalje edhe pse garon në baterinë B.

Unitedi, gati 91 milionë euro për Kanen

Manchester Unitedi ka gati një ofertë prej 91 milionë eurosh për sulmuesin e Tottenham Hotspurit, Harry Kane. Unitedi që një kohë të gjatë ka shprehur dëshirën për ta pasur sulmuesin anglez, kurse tash "Daily Star" raporton se trajneri Ten Hag e ka bërë Kanen objektivin kryesor. Në "Old Trafford" besojnë se me Kanen sezonin e ardhshëm do të jenë pretendentë kryesorë për ta fituar titullin në Premierligë. Unitedi, po ashtu, në listën e transferimit e ka edhe sulmuesin e Napolit, Victor Osimhen.

"Corriere dello Sport": Mourinho ka vendosur ta respektojë kontratën me Romën

Jose Mourinho qëndron te Roma. Për këtë është e bindur "Corriere dello Sport", e cila e largon portugezin nga thashethemet për t'u larguar nga "Olimpico". "Jose ka vendosur ta respektojë kontratën me Romën deri në skadimin e saj, më 30 qershor 2024", shkruan gazeta. Ai ka arritur në këtë përfundim dhe duket se ka vendosur të qëndrojë deri në fund në drejtimin e Romës. Thashethemet po shuhet tashmë. Si rezultat i qëndrimit të tij, mendohet se Dybala bashkë me Smalling do të qëndrojnë edhe pse zikaltrit e Interit janë të interesuar për dyshen e lartpërmendur.

Trajnerët legjendarë Ferguson e Wenger bëhen pjesë e "Hall of Fame"

Ish-trajneri i Manchester Unitedit, Sir Alex Ferguson dhe ish-trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, më 29 mars u bënë trajnerët e parë që u futën në

Hall Of Fame të Premierë Ligës, shoqatë që nderon futbollistët dhe menaxherët të cilët kanë kontribuar me vite për elitën e futbollit anglez. Ferguson është

trajneri më i suksesshëm në historinë e Premierligës, duke e udhëhequr Manchester Unitedin drejt 13 titujve, ndërsa Wengeri e fitoi kompeticionin tri

herë me Arsenalin, duke përfshirë ecurinë fantastike në sezonin 2003/04 që e mbylli pa asnjë humbje. Ferguson, i cili drejtoi Unitedin për më shumë

se 26 vjet, fitoi titullin inaugurues të Premierë Ligës më 1992/93 për t'u dhënë "Djajve të Kuq" suksesin e parë në ligë që nga viti 1967.



Shqiptarë Humanitare Barmirëse e Kosovës "Nina Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarne Dobrotvorne Udruženje Kosova "Majka Teresa"
38400 Prishtinë, Rr. Agim Ramadani, p.n. Tel:00381 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.ninateresa.org e-mail: ninateresa@yahoo.com

CONTRACT NOTICE SERVICES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 10/04/2023

Procurement No	Mentoring	002	2023	221
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. MujëKrasniqin.n.Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 038-542-865	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-869	
Internet address (if applicable):	www.mathteresasociety	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Individual consultancy-Mentoring and Coaching for 150 Women Beneficiary
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)
<input checked="" type="checkbox"/> Services
II.1.5) Short description of the object of the contract Individual consultancy-Mentoring and Coaching for 150 Women Beneficiary
II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) <input type="checkbox"/> 93.000.000.-8 <input type="checkbox"/>
II.1.7) Variants are accepted <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/> x
II.1.8) Division into lots <input type="checkbox"/> NO <input checked="" type="checkbox"/> x
Individual consultancy Mentoring and Coaching for 150 Women beneficiaries
II.1.11) Estimated contract value: Approximately 45,000.00

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 1 month (from the contract signature)
or
Starting 10/05/2023
Completion 10/06/2023

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required <input checked="" type="checkbox"/> NO
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/> x

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements: 1. Certificate of Business Registration 2. Fiscal Number Registration 3. VAT-Certificate if applicable Documentary evidence required Copy of documentary
III.2.2) Professional Suitability: 1. Business Registration Certificate 2. List of proposed experts and administrative staff and their cv-s 3. References of previous experience in similar projects Documentary evidence required: Copy of prove documents
III.2.3) Economic and financial capacity 1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo (for Winner Company only) 2. Certificate from Justice that's Company and person representative is not on any justice process (for Winner Company only) 3. Company profile Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.4) Technical and professional capacity 1. Business Registration Certificate 2. List of proposed experts and administrative staff and their cv-s 3. References of previous experience in similar projects Documentary evidence required:

Copy of prove documents

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/>
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service <input type="checkbox"/> Yes <input checked="" type="checkbox"/>

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure Open
--

IV.2) AWARD CRITERIA

Lowest price

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier Time limit for receipt of requests for tender dossier: date 17/04/2023
Payable documents <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.3) Time limit for receipt of tenders Date 03/05/2023 time 14:00 place Prishtina
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders <input type="checkbox"/> no
IV.3.5) Is tender security needed: <input type="checkbox"/> No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.6) Tender validity period: date: 03/05/2023 days 30 or months 1
IV.3.7) Tender opening meeting: Date 03/05/2023 time 14:30 place Prishtina

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Senahid Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesën e kl X Q.K "11 Marsi " Prizren.

- Besart Samadrexha shpall te pavlefshme certifikatën Q.K "11 Marsi " Prizren.

- Valbon Gashi shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi " Prizren.

- Erion Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfm " Fadil Hisari " Prizren.

- Gazmen Zajmi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e kl. 1.2.3.4. të sh.m Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Haxhi Furra nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të Gjimmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275


- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

ZYRTAR/E ADMINISTRATIV/E PËR KOMISIONE TË PËRHERSHME

Numri i pozitave: 2 (dy vende pune),

Nr. ref: 03/2023

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Merr pjesë në mbledhje të organeve të Odës dhe komisioneve të përhershme të Odës me qëllim të ofrimit të asistencës;
- Mbanë evidencën e mbledhjeve të komisioneve të përhershme të Odës dhe organeve të tjera ku kërkohet;
- Siguron materialet e nevojshme për mbledhjeve të komisioneve të përhershme;
- Mbanë dhe përgatit procesverbalet e takimeve;
- Mirëmbanë dosjet e komisioneve të përhershme;
- Ndihmonë anëtarët e komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OMK-së si dhe palëve të tjera;
- Kujdeset për zhvillimin e proceseve që ndërlihen me vendimmarrjen e komisioneve të Odës; dhe
- Kryen dhe punë të tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe sipas nevojave të organeve të Odës dhe shërbimit profesional në përgjithësi.

- Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë:** Njëra pozitë Udhëheqësit të Zyrës për Administratë dhe Financa
- Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë:** Njëra pozitë Udhëheqësit të Zyrës Ligjore

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë të kryer Fakultetin në fushat relevante, niveli bachelor;
- Një (1) vitë përvojë pune në administratë;
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjesi;
- Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të anëzime uanëzime ane për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS


Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 29.03.2023 deri më 13.04.2023, ora 16:00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 049/872-300 apo 038/544-872.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

SEKRETAR/E I/E PËRGJITHSHME I/E ODËS

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 01/2023

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Siguron këshilla të politikave për Kryetarin dhe organet e tjera të OMK-së;
- Siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të organeve të OMK-së të zbatohen në mënyrë efektive dhe efektive;
- Siguron që masat zbatuese të Odës të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave;
- Lëshon urdhëresa dhe udhëzime për kryerjen e punëve me miratim të organeve të OMK-së;
- Menaxhon personelin e Shërbimit Profesional;
- Menaxhon rrjedhën e informacionit në OMK;
- Bashkëpunon me sekretarët e Odave tjera në baza të rregullta;
- Koordinon raportin e organeve të OMK-së me organet e saj vartëse administrative; dhe
- Kryen edhe punë të tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas kërkesës së Kryetarit të OMK-së dhe Këshillit Drejtues të OMK-së.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Kryetari i OMK-së

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të jetë i diplomuar në ndonjërin nga degët e fakulteteve si: Mjekësi, Juridik, Ekonomik, Administratë Publike apo të avancuar (studime master të fushën e menaxhimit);
- Të ketë shkathësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negociimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri të standardeve të integritetit, ndershmërisë dhe drejtësisë;
- Së paku 5 (pesë) vite përvojë pune menaxheriale pas diplomimit;
- Plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe Statut të OMK-së;
- Njohja e gjuhës angleze e obligueshme;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!


Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 29.03.2023 deri më 13.04.2023, ora 16:00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 049/872-300 apo 038 / 544-872.

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

ZYRTAR/E I/E LARTË EKZEKUTIV PRANË ZYRËS SË KRYETARIT

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 02/2023

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Siguron mbështetje të përgjithshme administrative dhe teknike përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, faksimë dhe kopjimin e dokumenteve, si dhe hartimin e dokumenteve për takime të ndryshme;
- Përgatit dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet dhe shkresat elektronike për punëdhënësin;
- Pranon dhe shpërndan korrespondencën për mbikqyrësin dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;
- Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së punëdhënësit;
- Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve të tjera për mbikqyrësin si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik;
- Pranon palët për Kryetarin e OMK-së dhe udhëheqësit tjerë të Odës, orienton palët te personat kompetent, dhe
- Kryen edhe detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga punëdhënësi.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Kryetari i OMK-së

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë:

- Ta këtë të kryer Fakultetin Juridik apo në fushat relevante, niveli bachelor;
- 1 (një) vitë përvojë pune;
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjuesi;
- Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze obligative;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **29.03.2023** deri më **13.04.2023, ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300** apo **038 / 544-872.**

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

UDHËHEQËS/E I/E ZYRËS LIGJORE

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 04/2023

Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Koordinon, menaxhon dhe mbikëqyr punën e Zyres Ligjore të OMK-së;
- Ofron udhëzime dhe këshilla profesionale në kuadër të Zyres Ligjore;
- Harton dhe zhvillon legjislacion, akte normative si dhe akte të tjera juridike, kontrata, marrëveshje të cilat dalin nga fushëveprimtaria e OMK-së në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Monitoron ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës;
- Siguron që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të përgatitura nga ZL të jetë sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik;
- Drafton opinione/memorandume/përmbledhje ligjore në çështje të ndryshme ligjore kërkuar nga organet e ndryshme me aktivitetet e Odës;
- Bën hulumtime dhe analiza të ndërlidhura me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për stafin dhe organet e OMK-së;
- Harton raportet e punës të Zyres Ligjore;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesave të Sekretarit të Përgjithshëm në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme si dhe aktet e brendshme të OMK-së.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Sekretari i Përgjithshëm i OMK-së

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë:

- Të jetë i diplomuar në Fakultetin Juridik, apo të avancuar (studime master);
- 3 (tre) vite përvojë pune menaxheriale;
- Plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe Statut të OMK-së;
- Njohja e gjuhës angleze e obligueshme;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **29.03.2023** deri më **13.04.2023, ora 16:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872-300** apo **038 / 544-872.**

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients


[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten free



cilësi e garantuar

pa konservues